

18.05.2021

Ora 11:14

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr. 36, 1.” Kundërshtimi i vendimit nr. 345, datë 04.05.2021 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Vlorë; 2. “Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021”; “Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Qarkun Vlorë” dhe nr. 49 1. “Ndryshimin e vendimit të KSHZ nr. 345, datë 04.05.2021”; 2. “Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të gjithë Qarkun Vlorë”, subjekti ankues PD dhe LSI”.

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA,  
Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O. Peto
- **Parti politike:** PD, PS, LSI

*Z. E. Lako:* Atëherë, deklarojmë të çelur seancën e sotme “Për shqyrtimin bashkarisht të ankimeve nr. 36 të subjektit ankues Partia Demokratike e Shqipërisë dhe të ankimit nr. 49, subjekt ankues Partia Lëvizja Socialiste Për Integrim, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 345, datë 04.05.2021 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zonës zgjedhore Qarku Vlorë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021, pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021 zona zgjedhore Qarku Vlorë si edhe urdhërimi i përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore të Qarkut Vlorë në periudhën më të afërt zgjedhore.” Në seancën e datës 11 Maj

Zbardhi materialin audio

Jonida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

2021 KAS vendosi kalimin për shqyrtim të këtyre kërkesave ankimore duke qenë se të dyja kërkesat kishin të njëjtin objekt ankimi pra, kundërshtimin e vendimit nr. 345 të Komisionerti Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në këtë zonë zgjedhore.”, në bazë të nenit 19 pika 1 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve si edhe nenit 132 të Kodit Zgjedhor KAS vendosi shqyrtimin bashkarisht të tyre në një seancë të vetme me relator mua, Elvin Lako-n, sipas shortit të hedhur në datën 10 Maj 2021. Para se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes, verifikojmë legjitimitimin procedural të palëve pjesëmarrëse në proces. Fillojmë sipas rradhës me prezantimin e subjekteve ankuese, për Partinë Demokratike, Lëvizjen Socialiste Për Intergrim.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Për Partinë Demokratike i nderuar është zoti Ivi Kaso dhe Marash Logu me autorizim.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Lëvizja Socialiste Për Intergim, Altin Kaziaj, Kreshnik Kolndreu, dhe Uendi Gjoshi.

**Z. E. Lako:** Faleminderti, a ka kërkesë për palët e interesuara në proces?

**Z. Y. Merkaç:** Pranë Administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa nga subjekti politik Partia Socialiste, me përfaqësues ligjor zotin avokat Eridian Salianji.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, edhe ju gjithashtu një prezantim ju lutem.

*(audio ndërpritet)* Atëherë, i bëjmë pyetje palëve nëse kanë ndonjë kërkesë paraprake lidhur me anëtarët e KAS apo ndonjë kërkesë tjetër?

*Zbardhi materialin audio*

*Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Nuk kemi kërkesa paraprake i Nderuar.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk kemi.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, nga anëtarët e KAS ndonjë kërkesë, ndonjë rast? Atëherë, meqenëse nuk kemi kërkesa të tjera paraprake vazhdojmë me shqyrtimin e themelit të çështjes. Shkurtimisht Sekretari i Përgjithshëm nëse ka diçka për të thënë në lidhje me vendimin, objekt ankimi dhe pastaj të kalojmë me pretendimet e palëve.

**Z. Y. Merkaç:** Jo. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 345 ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore Qarku Vlorë, kundër këtij vendimi ka bërë ankim Partia Demokratike dhe Partia Lëvizja Socialiste Për Integrim duke mos qenë dakord me këtë vendim, e ka ankimuar tek KAS-i. Për më tepër besoj do ta shpjegojë ankimuesi.

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Atëherë, fillojmë me subjektin ankues Partia Demokratike, faleminderit.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit, i Nderuar. Siç u relatua dhe në këtë seancë në datën 09 Maj 2021 subjekti Partia Demokratike Alenaca Për Ndryshim ka paraqitur një ankim duke kundërshtuar vendimin nr. 345, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultateve zgjedhore në zonën zgjedhore Qarku Vlorë duke kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25 Prill 2021 në zonën zgjedhore Qarku Vlorë dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Vlorë. Ashtu siç kemi pasur mundësi të parashtrojmë edhe në seancat e tjera për një tipologji të ngjashme të shkeljeve që kanë shoqëruar të gjithë procesin zgjedhor do të ndalem shkurtimisht në ato që

*Zbardhi materialin audio*

*Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

përbëjnë specifikat e Qarkut Vlorë. Së pari i Nderuar do të ndalemi tek blerja e votës dhe përdorimi i personave me precedent të tmerrshëm kriminal të cilët në vlerësimin tonë çënuan rëndë procesin zgjedhor dhe përbejn kushtet e nevojshme për të shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve në këtë qark. Konkretisht ne do të ndalemi fillimisht në dy raste, të cilat janë evidentuar nga strukturat e Partisë Demokratike, por edhe organet ligjzbatuese të cilat në vlerësimin tonë përbejnë raste mjaft të rënda të cënimit të procesit zgjedhor. Në datën 21 Prill 2021 disa orë përpara së Kryetari i Partisë Demokratike zoti Lulzim Basha të vizitonte qytetin e Selenicës në fashtin Poro është qëlluar me kallashnikovë mbi lokalit e një simpatizanti të Partisë Demokratike i populluar nga simpatizantë dhe mbështetës të PD-së. Kjo ka sjell më pas në këtë fasht, por edhe në zonat përreth votuesit e Partisë Demokratike të ndjeheshin të kërcënuar, të frikësuar dhe mos të merrnin pjesë në votime ç'ka solli një rezultat mjaft të dobët në këtë zonë. Gjithashtu, i Nderuar i referuar edhe pranë organeve ligjzbatuese nga data 21 Prill 2021 rezulton se aktivisti i Partisë Demokratike, Arjan Shabani nga Selenica pas takimit të Kryetarit të PD-së në këtë zonë është deklaruar i humbur dhe deri më sot. Deri më sot policia nuk ka arritur të sigurojë asnjë informacion lidhur me këtë ngjarje. Familjarët kanë ngritur dyshime se kjo ngjarje mund të lidhet me aktivitetin e tij politik në muajt e fundit si mbështetës dhe aktivist i Partisë Demokratike pasi ishte kërcënuar disa herë për të mos vazhduar më tej aktivitetin e tij politik. Sa i përket denoncimeve apo kallëzimeve penale që Partia Demokratike ka bërë në SPAK për rastet e shit - blerjes së votës citoj si më poshtë, në datën 02 Prill 2021 Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shtetasit Afrim Qendro nënkryetari i Bashkisë Vlorë, shtetasin Klodian Troci drejtor i Agjensisë së Kadastrës Vlorë, shtetasin Erjon Osmanj drejtro i OSHEE Vlorë, të cilët me veprime konkrete kishin ngritur një struktur kriminale në Qarkun e Vlorës për blerjen e votës në këmbim të parave apo të përfitimeve të tjera të cilat vinin si rezultat i ushtrimit të funksionit publik nga këta tre shtetas. Sjell edhe njëherë në

*Zbardhi materialin audio*

*Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

vëmendjen tuaj se shtetasi Afrim Qendro është nënkryetari i Bashkisë Vlorë, shtetasi Klodjan Troci është drejtor i Agjensisë së Kadastrës ndërsa zoti Erjon Osmanaj është drejtor i OSHEE Vlorë. Të tre këta shtetas duke përdorur funksionet e tyre publike, por sigurisht edhe financime që vinin nga burime të paligjshme kanë ushtruar ndikim të drejtpërdrejt mbi vullnetin e votuesve qoftë nëpërmjet blerjes së votës, dhënies së legalizimeve apo dhënies së përfitimeve të tjera. I Nderuar do të kërkoja që në sallë të kishte pak më shumë qetësi, të lutem.

**Z. E. Lako:** Ju lutem përfaqësuesëve të medias në fund, ju lutem mbani pak qetësi. Qetësi ju lutem, po.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ne vlerësojmë i Nderuar se shit – blerja e votës qoftë nëpërmejt dhënies së të hollave apo përfitimeve të tjera materiale përbënë një shkelje të rëndë të Kodit Zgjedhor konkretisht të nenit 78, mjaftueshëm për të qenë në kushtet e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe përsëritjes së zgjedhjeve në këtë qark. Po ashtu, siç kemi relatuar dhe në kërkesat tona ankimore të mëparëshme blerja e votës nuk u realizua vetëm nëpërmjet dhënies së të hollave, por edhe nëpërmjet dhënies së të mirave materiale, bonuseve apo përfitimeve të tjera. Konkretisht në Qarkun e Vlorës janë konstatuar në disa raste në mënyrë të përsëritur përdorimi makinacioneve të dhënies së ndihmave ushqimore për familjet në nevoj për qëllime zgjedhore. Kjo praktik është zbatuar nga disa figura dhe zyrtarë të lartë të Partisë Socialiste si vijon, zonja Vilma Bogo kandidate dhe deputete e Partisë Socialiste për Qarkun e Vlorës së bashku me drejtuesin politik të Qarkut Vlorë në datat 18 dhe 30 Dhjetor kanë shpërndarë dhurata dhe ushqime për kategori të caktuara individësh me qëllime thelësisht elektorale. Veprime të ngjashme janë bërë edhe nga individë të tjerë pranë Partisë Socialiste si kandidati për deputet dhe deputeti Vullnet Sinaj në datën 02 Janar 2021 dhe nga deputeti i Kuvendit të Shqipërisë Alket Hyseni në datën 27 Dhjetor 2020. Ndërkaq i Nderuar në kundërshtim të pastër me nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 3 të

*Zbardhi materialin audio*

*Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

vendimit nr. 9, 2020 në datë 25 Shkurt 2021 Këshilli Bashkiak i Vlorës i drejtuar tërësisht, po themi nga këshilltarët socialistë dhe kryebashkiak socialistë ka miratuar një vendim për dhënien e kredive të buta në kundërshtim kjo në fakt me nenet e sipër cituara, të cilat ndalojnë që në periudhën 4 muaj para zgjedhjeve të nxirren vendime që sjellin përfitime për kategori të caktuara shoqërore. Ndërkoh që duke qenë se dhe në seancat e mëparshme kemi relatuar vendime të Këshillit të Ministrave që kanë sjell përfitime për kategori të caktuara shoqërore nuk do të ndalemi më tej. Megjithatë vlen për t'u thënë i Nderuar se në datën 24 Prill 2021 Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Vlorë ka shpërndarë tollona naftë, tollona karburanti për fermerët vetëm një ditë para zgjedhjeve me qëllime të pastra elektorale me qëllim ndikimin e vullnetit të këtyre zgjedhësve. Sa i përket shtyllës së dytë shumë e rëndësishme vendosja e shtetit në shërbim të partisë duke përdorur në mënyrë të paligjshme burime shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve ne kemi sjellur fakte dhe prova se si e gjithë Administrata Publike u vendos në funksion të Partisë Socialiste për zgjedhjet. Konkretisht në datën 28 Shkurt 2021 zoti Damian Gjoknuri drejtues politik i Qarkut Vlorë për Partinë Socialiste i shoqruar nga nënkryetari i Bashkisë Vlorë zoti Afrim Qendro dhe prefekti i qarkut zoti Flamur Mamaj ka zhvilluar takime me administratën e operatorit të sistemit transmetimit Vlorë në Pallatin e Kulturës Vlorë. Është për t'u theksuar se Pallati i Kulturës është në administrim të Bashkisë Vlorë dhe gjatë të gjithë fushatës ka funksionuar si zyrë elektorale e Partisë Socialiste. Gjatë këtij takimi me dyer të mbyllura i'u është kërkuar punonjësve të OST-së që të angazhohen për vota në favor të Partisë Socialiste pra, kemi dy shkelje të pastra të Kodit Zgjedhor. Së pari janë përdorur burime, asete publike të vendosura në dispozicio të Partisë Socialiste konkretisht godina e Pallatit të Kulturës dhe e dyta ka të bëjë me përdorimin e Administratës për fushatë zgjedhore po ashtu e ndaluar shprehimisht nga neni 91 i Kodit Zgjedhor. Nga ana tjetër i Nderuar sa i përket punësimeve në Administratën Publike si shkelje e rëndë e ligjit për përfitim politik duke devijuar vullnetin ne kemi pasur mundësi tashmë të parashtojmë

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

përpara jush shtimin që ndodhi në punsimet në Administratë Publike prej rreth 13 mijë punojës në një periudh fare të shkurtër prej 4 muajsh e për më tepër kemi referuar se sipas të dhënave që janë marrë pranë Ministrisë së Financave vetëm shpenzimet për paga u rritën në periudhën Mars – Prill 2021 me 63 milionë euro më shumë se e njëjta periudhë e krahasuar me Mars – Prill 2020. Kjo në fakt provon që punësimet në Administratën Publike u përdorën masivisht nga partia në pushtet, e cila kotrollon dhe kontrollonte gjithçka për të punuar njerëz me qëllim që më pas këto të përktheheshin në vota dhe mbështetje për Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj. Po ashtu shumë e renësishme është dhënia e lejeve të legalizimit dhe ndërtimit gjatë fushtës zgjedhore si edhe veprimtari të tjera publike të ndaluara që kanë të bëjnë në fakt me dhënien po themi e tenderave ose koncesionarëve pikërisht në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor. Konkretisht në datën 24 Dhjetor 2020 deputeti i Kuvendit të Republikës së Shqipëris për Partinë Socialiste zoti Alket Hyseni ka publikuar një veprimtari publike së bashku me drejtorin e përgjithshëm të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës zotin Artan Lame duke shpërndarë leje legalizimi për qytetarë të qyteti të Vlorës. Në datën 26 Dhjetor 2020 Vullnet Sinaj deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe kandidat për deputet shihet gjithashtu pranë Drejtorisë së Kadastrës Vlorë duke shpërndarë leje legalizimi për qytetarë të qytetit Vlorë në shkelje në fakt të nenit 1 pika 1 3 a të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator të KQZ-së. Po ashtu, kemi pasur mundësi ta relatojmë edhe më përpara faktin që në datën 21 Prill u publikua një audiopërgjim i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjesnisë Shtetërore të Kadastrës zoti Artan Lame, i cili u kërkonte vartësve të tij që të mbanin të pezulluar rreth 100 mijë kërkesa për leje legalizimi pasi nëse ato refuzoheshin dhe shtëpit e qytetarëve prisheshin kjo do të sillte më pas që këto vota të shkonin për palën kundërshtare. Kjo seancë i Nderuar ndiqet edhe nga qytetarë edhe nga qytetarë të Qarkut Vlorë jam i bindur që e dinë për çka do të flas në këto momente, shumë qytetarë, me qindra qytetarë kanë marrë këto ditë që ne flasim njoftime nga IKMT-ja për prishjen e banesave, shtëpive të tyre apo bizneseve qartazi pasi

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALHARI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

kishte përfunduar fushata elektorale dhe zgjedhjet ku i është premtuar që shtëpitë e tyre dhe bizneset nuk do të prishen. Kjo në fakt siç ne e kuptojmë dhe vlersojmë ligjin përbenë një shkelje të pastër të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, të vendimit nr. 9, 2020 ku shteti përdoret si mekanizëm për të sjell mbështetje për një parti të caktuar politike, në rastin konkret për Partinë Socialiste të Shqipërisë. Po ashtu, në shkelje të nenit 3 dhe 4 të vendimit nr. 9, 2020 Minitria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpalli në datën 06 Janar në Angjensinë e Prokurimit Publik tenderin me objekt dhënie me koncesion PPP për projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim e një porti turistik në qytetin e Vlorës, besoj se të gjithë këtu e njohim vendimin nr. 9, 2020, i cili ndalon shprehimisht që në periudhën 4 muaj para zgjedhjeve të bëhet publikimi apo të organizohen procedura të dhënies me PPP apo koncesion të projekteve publike për shkak se ato mund të kenë një ndikim të caktuar mbi vullnetin e zgjedhësve. Po ashtu, i Nderuar në kërkesën tonë ankimore kemi relatuar vjedhjen dhe përdorimin e paligjshëm që i'u bë të dhënave personale, i cili siç provohet nga fakte të shumta u përdorë jo vetëm në Tiranë e Durrës ku kanë dal edhe emrat e qytetarëve dhe të dhënat e tyre personale, por në të gjithë territorin e Shqipërisë e për rrjedhojë edhe në Qarkun e Vlorës. Kjo në fakt provohet edhe nga deklaratat e shumta të shtetasit Edi Rama me detyrë Kryeministër dhe kryetar i Partisë Socialiste, shtetasit Taulant Balla me detyrë Sekretar i Përgjithshëm apo shtetasit Damian Gjijnuri me detyrë deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe drejtues politik i këtij qarku që falenderojnë patronazhistët për rezultatin historik që morën në zgjedhjet e 25 Prillit për Qarkun e Vlorës. Po ashtu, i Nderuar mohimi i të drejtës për të votuar i emigrantëve vlersojmë se ishte një cënim i rëndë që i'u bë procesit zgjedhor në Qarkun e Vlorës. Vendimi i Komitetit Teknik të Ekspertëve për të ndaluar rreth 500 mijë shqiptarë me të drejtë vote që jetojnë në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut për të votuar në Republikën e Shqipërisë në zgjedhjet e 25 Prillit ishte në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës, nenin 3 pika 1 e Protokollit të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe sigurisht me një sërë parashikimesh të akteve të tjera

*Zbardhi materialin audio*

*Jonida SALILLARI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

ligjore që garantojnë të drejtën e çdo shtetasi në Republikën e Shqipërisë për të votuar. Por, ajo çka e bënë më të rëndë këtë vendim është në fakt një provë që ne e morëm në kuadër të një procesi tjetër. Janë pikërisht këto vendime të KZAZ-ve të Gjirokastrës të cilat fal nenit 136 pika 3 me kërkesë të dy anëtarëve u morën që provojnë se votuesit të Partisë Socialiste jo vetëm u lejuan që të vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut, por ata shërbyen edhe në komisionet e qendrave të votimit qoftë si komisioner apo si numërues të grupeve të numërimit. Pra, qartazi ndalimi që i'u bë emigrantëve për të ardhur në Shqipëri për të votuar në zgjedhjet e 25 Prill-it nuk ishte një ndalim që kishte për qëllim të ruante shëndetin publik siç u maskua nga Komiteti Teknik i Ekspertëve, por kishte për qëllim që të ndalonte vetëm mbështetësit e opozites që të votinin në zgjedhjet e 25 Prillit. Kjo pasi votuesit dhe mbështetësit e Partisë Socialiste jo vetëm erdhën dhe votuan, por edhe ishin pjesë e administratës zgjedhore që funksionoi në datën 25 Prill 2021. Po ashtu, i Nderuar në kërkesën tonë ankimore kemi relatuar faktin se si vendimmarrja tërësisht në vlerësimin tonë e paligjshme dhe në kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor, por edhe pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore sa i përket fletës së votimit solli në Qarkun e Vlorës plotë 4730 fletë të pavlefshme ose 4.43% të totalit të votuesëve në Qarkun e Vlorës. Së fundmi, po ashtu shumë e rëndësishme në kërkesën tonë ankimore kemi relatuar se si nga informacionet që ne kemi marrë edhe në Qarkun e Vlorës u konstatuan raste të shumta të votimit më shumë se njëherë të qytetarëve për këtë sigurisht që edhe në këtë proces ne do të kërkojmë të administrohen të dhënat nga kryqëzimi i pajisjeve PEI, të cilat si në rastin e Beratit ashtu edhe në rastin e Gjirokastrës jemi të bindur se kemi të bëjmë me raste të shumta të votimit më shumë se sa njëherë. Për të përfunduar i Nderuar ne vlerësojmë se tërësia e këtyre shkeljeve veçanërisht blerja e votës nëpërmjet përdorimit të personave me precedent të tmerrshëm kriminal, përdorimi i Administratës Publike, i punësimeve, i legalizimeve, i ndihmës ekonomike, i bonuseve apo i përfitimeve të tjera, ndalimi i 500 mijë zgjedhsve shqiptarë për të ardhur të votonin më 25

*Zbardhi materialin audio*

*Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

Prill, vjedhja dhe përdorimi i paligjshëm i të dhënave personale, votimi më shumë se sa njëherë dhe 4730 fletë të pavlefshme si rezultat i një flete votimi tërësisht konfuze siç u konstatua dhe nga raporti paraprak i OSBE/ODIHR përbëjnë shkelje të rënda të ligjit, të cilat e kanë çënuar procesin zgjedhor në Qarkun e Vlorës në atë masë sa ky Komision duhet të konstatojë ose të shpallë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në Qarkun e Vlorës dhe të urdhërojë përsëritjen e tyre për të garantuar zgjedhje të lira, të ndershme dhe të barabarta për të gjithë votuesit në Qarkun e Vlorës, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, vazhdojmë me subjektin tjetër ankues Lëvizja Socialiste Për Integrim.

**Znj. U. Gjoshi, përfaqësuese e LSI-së:** Faleminderit, atëherë të nderuar anëtarë të KAS ashtu siç ne e kemi referuar Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon se të drejta dhe lirit e njeriut janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektoj dhe t'i mbrojtë ato. Shtetasi shqiptarë ka të drejtë të lëviz lirisht dhe të zgjedh sipas dëshirës vendbanimin e tij brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë më tej akoma Kushtetuta parashikon si të drejtë dhe liri themelore të shtetasit të drejtën të zgjedh dhe të zgjidhet. Me urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 219, datë 19.04.2021 për vendosjen në karantinë 2 javore të shtetasve shqiptarë që vinë nga Greqia apo Maqedonia e Veriut në thelb është mohuar e drejta kushtetuese e zgjedhësve shqiptarë me banim në Greqi dhe Maqedonin e Veriut për të ushtruar të drejtën e tyre të zgjedhin lirisht për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25 Prill 2021. Pikërisht kjo masë e propozuar dhe e marrë 4 ditë para datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë provoj se vendimmarrja propozuese e Komitetit Teknik të Ekspertëve dhe akti miratues i Ministrisë të Shëndetësisë ishin akte të formësuar nga një vullnet jo objektiv dhe të orientuar politikisht e që solli si pasojë direkte negative pengimin e këtyre qytetarëve për ushtrimin e të drejtës së votës. Ky

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

orientim politik u pa qartë me anulimin më datë 03 Maj 2021 të këtij urdhëri pikërisht pak ditë pas mbarimit të zgjedhjeve. Vendosja e masave të tilla pak ditë para ditës së votimit dhe heqja e masave pak ditë pas mbarimit të procesit të votimit dëshmon për një vullnet të orientuar politikisht duke penguar shtetasit shqiptarë me banim në Greqi dhe Maqedonin e Veriut të ushtrojnë të drejtën kushtetuese të votës. Duhet theksuar se edhe pse nuk kishte dal ende një akt zyrtarë rregullues nga Keshilli i Ministrave apo Ministria e Shendetësisë mbi masat e karantinimit 2 javorë për shtetasit që vinin nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut duket se vetëm mbi bazën e njoftimit publik autoritetet policore në datën 20 Prill 2021 e në vijim në pikën kufitare me Greqin kërkonin prej qytetarëve plotësimin e formularëve për vetëkarantinim ndërkohë që në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, ende nuk ishte botuar një akt i autoritetit kompetentë me fuqi juridike përkundrajt pasojave të tij rregulluese. Akti është publikuar në Fletoren Zyrtare vetëm në datën 21.04.2021 në orët e vona të pasdites, 2 ditë pas njoftimit publik nga Komiteti i Ekspertëve dhe kjo vonesë ka ndodhur pavarësisht pasojave dhe efekteve që ai sjell, ka ndikim të drejtpërdrejt në levizjen e lirë dhe në mos pjesëmarrjen e këtyre shtetasve në zgjedhjet e përgjithshme të 25 Prill-it. Ende pa u botuar akti në Fletoren Zyrtare shtetasve shqiptarë në kufi që hynin në territorin e Republikës u kërkohej nënshkrimi i një formulari me detyrim për vetëkarantinimin 14 ditorë. Kjo kërkesë ka ardhur mbi bazën e një akti që nuk kishte hyr ende në fuqi pasi urdhëri nr. 219, të datës 19.04.2021 i Ministrisë të Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si një akt me karakter normativ në përputhje me nenin 117 pika 1 të Kushtetutës merr fuqi juridike vetëm pasi bëhet i ditur përmes botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Një akt i tillë në situatën konkrete jo vetëm që ka penguar emigrantët shqiptarë të hynin nga Republika e Greqisë dhe ajo e Maqedonisë së Veriut, por nga mënyra se si ka nisur implementimi i tij përmes detyrimit për të nënshkruar një formular dhe për t'u vetëkarantinuar për 14 ditë pa marrë në konsideratë as rastet kur nëse shtetasit paraqesin testin e kryer PCR apo çdo test tjetër laboratorik që vërteton negativitetin

*Zbardhi materialin audio*

*Joniida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.18.05.2021*

ndaj Covid – 19. Kjo ka cënuar rëndë garancinë kushtetuese të këtyre shtetasve për të hyr në territorin e atdheut të tyre për të ushtruar të drejtën kushtetuese të votës. Disa shoqata emigrantësh, përfaqësues të shoqërisë civile bënë apel për heqjen e ktyre masave edhe insitucioni President i Republikës si autoriteti dekretues i datës së zgjedhjeve dhe garantues i të drejtave kushtetuese të shtetasve shqiptarë me banim brenda apo jashtë vendit përmes shkresës me numër protokolli 1413, datë 24.04.2021 drejtuar Këshillit të Ministrave, Ministisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komitetit Teknik të Ekspertëve, organeve drejtuese dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Drejtroisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Avokatit të Popullit, përfaqësive të huaja dhe të gjithë partive garuese kërkojë marrjen e masave urgjente lidhur me heqjen e pengesës për ushtrimin e të drejtës së votës nga ana e emigrantëve shqiptarë që kthehen në Shqipëri nga Greqia dhe Maqedonia duke theksuar pasoja direkte që ka një masë të tillë propocionale me ushtimin e të drejtës themelore për të zgjedhur pra, votuar edhe nga ana e emigrantëve shqiptarë. Avokati i Popullit përmesë shkresës nr. 222, Tiranë, 21.04.2021 drejtuar Ministrit të Shendetësisë dhe Mbrojtejes Sociale, zonjës Ogerta Manastirliu, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronaviusi parqaiti rekomanimin për anulimin tërësisht e menjëherë të urdhërit nr. 219, datë 19.04.2021 për karantinimin e personave që vinë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia. Në vijim edhe procesi i votimeve në Qarkun Vlorë ka qenë i cënuar në thelb pasi është cënuar e drejta kushtetuese e votuesëve shqiptarë me banim në Greqi, të cilët kanë qenë të regjistruar në listën e zgjedhësve të Qarkut Vlorë që nga Saranda e deri në Nartë dhe janë penguar në ushtrimin e të drejtës kushtetuese të votës. Për të vlerësuar impaktin e këtij urdhëri në procesin zgjedhor të Qarkut Vlorë mjafton të marrim në analizë rezultatin e pjesëmarrjes në zgjedhje në 10 vitet e fundit në raport me pjesëmarrjen në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021 nga ku rezulton qartë se kemi një numër më të ulët pjesëmarrjeje. Sqaroj

*Zbardhi materialin audio*

*Johida SALILLARI*



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve***

***Dt.18.05.2021***

përpara jush se pikësisht pjesëmarrja më e lartë e zgjedhësve përfshirë zgjedhsit shqiptarë me banim në Greqi e kostataur në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin apo zgjedhjet vendore kanë qenë vendimtare në rezultatin zgjedhor të subjektit Lëvizja Socialiste për Integrim. Më konkretisht, subjekti Lëvizja Socialiste për Integrim ka arritur të sigurojë një mandat deputeti në zgjedhjet e vitit 2013 dhe në zgjedhjet e vitit 2017, ndërkohë që në zgjedhjet e vitit 2021 nuk ka arritur të sigurojë një mandat deputeti pikërisht nga vendimet e sipër cituara anti kushtetuese. Statistikat e pjesëmarrjes, referuar faqes zyrtare on-line të KQZ-së, janë një tregues mjaft i qartë se përse...

***Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

**Znj. U. Gjoshja, përfaqësuese e LSI-së:** Urdhri i MSHMS, nr. 219, datë 19.04.2021, ka pasur për qëllim të godasë politikisht, drejtpërdrejt subjektin zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim. Ky fakt reflektohet edhe në rezultatet zgjedhore të sipërcituar. Në vijim të këtij arsytimi, edhe vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 345, datë 4.05.2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse, për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatet për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë datë 25 prill 2021, është i paligjshëm dhe duhet të prishet pasi ndodhemi në kushtet e parashikuara në nenin 160/1 të Kodit Zgjedhor. Më qartë neni 160, pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit, ndryshuar pikat 1 dhe 2 më ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi në rast se kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor, ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit sipas kësaj shkronje ka ndodhur në ato qendra votimi dhe mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që, mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore si dhe ka ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim. Është fakt i mirënjohur ndërkombëtar që ndodhemi në një situatë pandemie, akti normativ, urdhri i ministrit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale nr. 219, datë 19.04.2021, ka penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve të qarkut Vlorë, të ushtrorë të drejtën kushtetuese të votës. Në këto kushte, në vlerësimin tonë, kërkojmë prishjen e vendimit nr. 345, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, dhe shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për qarkun Vlorë. Sa më sipër kërkojmë ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 345, datë 4.05.2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse, për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatet për deputetë në zgjedhjet për kuvendin e

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021**

Shqipërisë datë 25 prill 2021, dhe shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qarkun Vlorë. Provat që paraqitem, burimet si dhe numrin e tyre i kemi të bashkëlidhura. Vendimin nr. 345, datë 4.05.2021, i komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve, rekomandimin nga ana e avokatit të popullit nr. 222, datë 21.04.2021, pyetëtori tip i Ministrisë së Brendshme për shtetasit që kthehen nga zonat e prekura nga virusi Cov 19, ...

**Z. E. Lako:** Më fal me administrimin e provave do të kalojmë më poshtë,

**Znj. U. Gjoshja, përfaqësuese e LSI-së:** Dakord! Ndjesë!

**Z. E. Lako:** Atëherë faleminderit përfaqësueses së subjektit ankues, Lëvizja Socialiste për Integrim. Atëherë fjalën ia japim përfaqësuesit të palës së interesuar zotit Salianji.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i LSI-së:** Po, faleminderit! Për sa i përket ankimit të paraqitur nga ankuesi, do të thosha që në aspektin formal, procedural ligjor, ankimi nuk qëndron, nuk duhet të shqyrtohet nga ana juaj, për arsye së Kodi Zgjedhor në pjesën kreu 2, neni 160 për pavlefshmëri, e përcakton fare qartë së si ngrihet një kërkesë për pavlefshmëri. Ky Kod thotë, pika e parë, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit zgjedhor i shpall zgjedhjet të pavlefshme, në një apo disa qendra votimi. Në asnjë prej kërkesave nuk dëgjuam çfarë shkeljesh kanë ndodhur në një ose shumë qendra votimi për rastin e Vlorës. Pra ana ligjore e procedurale nuk është respektuar dhe nga ky moment nuk duhet ta shqyrtoni apo ta merrni për bazë këtë ankim. Për sa i përket thelbit, do thosha që është hera e tretë që dëgjoj të njëjtën kërkesë. Me pak ndryshime përkatëse; dy ndryshime vura re; ndryshimi i parë është

**Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

dhënia e pallatit të kulturës në përdorim, kjo është shkelje e ndryshme nga ato që janë në Berat dhe në Gjirokastrë, dhe e dyta falënderimi i patronazhistëve. Pra, dy shkelje u paraqiten këtë herë për sa i përket Vlorës. Do të thosha që ne e kemi dëgjuar dhe opozitën për respekt do ta dëgjojmë, së normal për këtë jemi këtu, besoj, efektin publik e politik këto kërkesa e kanë dhënë; të mos i hamë kohën KAS-it. Në kërkesat që nuk kanë asnjë vlerë ligjore, ....!!! ne duhet të ecim shpejt; të rrezohet kërkesa dhe të ecet me shpalljen e rezultatit përfundimtar. Kërkojmë mirëkuptimin e opozitës që mbasi e kemi dëgjuar tre herë kërkesën, të paktën tani të tërhiqet nga kërkesat e tjera ankimore, sepse është hera e tretë dhe nuk po thotë asgjë të re në lidhje eventuale që mund të kenë ndodhur në qendrat e votimit, por e përdor këtë tavolinë për debat publik e politik. E ka këtë të drejtë por kjo e drejtë e ka dhënë efektin, besoj, ligjor dhe publik dhe kërkoj mirëkuptimin e tyre që kërkesat ankimore të tjera të tërhiqen dhe ne të vazhdojmë me shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Salianji! Anëtarët e KAS-it tani kanë të drejtën për pyetje.

**Z. L. Braho:** Kisha një sqarim për zotërinë! Zoti Salianji ju jeni i lirë të rrini sa të doni, të dëgjoni sa të doni; opozita mbasi i ka këto kërkesa për çdo qark specifik dhe në qoftë së këto kanë ndodhur në çdo qark duhen thënë për çdo qark. Kështu që është e drejta e saj që ti parashtroje të gjitha këto. Ne këtu jemi, natyrisht kur diçka nuk duhet dëgjuar ne jemi të vendosur për ta bërë këtë. Natyrisht ti e ke parë këtë gjë. Edhe ndaj teje është vendosur masë që ti të mos flasësh.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i LSI-së:** Po, ...!!

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

**Z. L. Braho:** Kështu që ....


**Z. E. Salianji, përfaqësues i LSI-së:** Opozitës kurrë të mos i ndërpritet fjala!

**Z. L. Braho:** Ju jepni prapësimet tuaja për ato që referon opozita.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Braho. Ndonjë pyetje nga anëtarët e tjerë të KAS-it?! Atëherë, meqenëse nuk ka pyetje nga ana e anëtarëve të KAS-it, vazhdojmë në mbështetje të pikave 2 dhe 3 të nenit 136 të Kodit Zgjedhor, me administrimin e provave dhe të kërkesave eventuale nëse ka prova të reja. Fillimisht, me subjektin ankues Partia Demokratike.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Atëherë, besoj do të rehatojmë prova që kemi paraqitur dhe kërkojnë të administrohen dhe provat e reja që kërkojmë nga ana e KQZ-se dhe KAS-i, po themi, që të merren nga institucionet e tjera publike! Për sa i përket provave që ne kemi paraqitur, i nderuar, dhe që kërkojmë të administrohen nga ana juaj, i keni të cituara në faqen 50 dhe 51 të kërkesës tonë ankimore, megjithatë, për efekt të këtij procesi po i citojmë serish. Konkretisht, prova nr. 1 ka të bëjë me takimet elektorale që zhvillonte partia demokratike në qarkun e Vlorës, gjatë të cilave është qëlluar me kallashnikov drejt ambienteve të mbështetësve të Partisë Demokratike, Vlorë; prova nr. 2 ka të bëjë me kallëzimin penal të datës 2.04.2021, kundrejt shtetasve Afrim Qëndro, nënkryetar i bashkisë, Vlorë, Gledion Troci drejtor i ASK-se vendore Vlorë dhe Orion Osmanaj drejtor i OSHEE-se Vlorë; prova nr. 3, apo le të themi provat vijuese kanë të bëjnë me denoncime të vazhdueshme për sa i përket shpërndarjes ose dhënie së ndihmës në mallra

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

ushqimore nga ana e deputeteve të partisë socialiste, konkretisht nga ana e Vilma Bello, Vullnet Sina dhe Alket Hyseni me qëllime të pastra, në vlerësimin tonë, elektorale. Prova tjetër është vendimi nr. 19, i këshillit bashkiak Vlorë i datës 25.02.2021, për dhënien e kredive të buta nga ana e Bashkisë Vlorë, në një kohë që kjo ishte e ndaluar nga neni 91 i Kodit zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020, pasi ishim në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve. Prova tjetër ka të bëjnë me tre vendime të këshillit të ministrave, të cilat siç janë relatuar edhe në seancat e mëhershme kanë krijuar përfitime të dukshme për kategori të caktuara shoqërore. Prova tjetër, ajo me nr. 10 ka të bëjë në fakt me përdorimin e pallatit të kulturës për qëllime elektorale, e ndaluar kjo, në vlerësimin tonë, nga vendimi nr. 9/2020, duke qenë së është aset publik. Prova tjetër ka të bëjë me statistikat zyrtare nga instituti i punësimeve nga sektori publik në tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2020. Prova 13 ka të bëjë me tollonat e naftës që janë shpërndarë për fermerët vetëm një ditë përpara zgjedhjeve, në qarkun e Vlorës nga drejtoria rajonale e bujqësisë. Prova nr. 14 ka të bëjë me raportin paraprak të OSBE, ku kemi konstatuar disa gjetje që mbështesin në fakt pretendimet e partisë Demokratike. Prova nr. 15 ka të bëjë me materiale foto, video, të deputetit Alket Hyseni duke shpërndarë leje legalizimi në aktivitete publike, në krah të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, zotit Artan Lame. Prova me nr. 16 ka të bëjë me materiale foto dhe video të publikuara në faqen zyrtare të kandidatit për deputet, Vullnet Sina, brenda ambienteve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës duke shpërndarë leje legalizimi. Prova nr. 17 ka të bëjë me njoftimin në faqen zyrtare të agjencisë së prokurimeve publike për tenderin e koncesionit të portit të Vlorës për një periudhë 35 vjeçare, e publikuar në datën 6 janar 2021. Kjo periudhë, sipas nenit 3 të vendimit nr. 9/2020, është e ndaluar për të bërë shpallje apo marrë vendime të kësaj natyre. Prova nr. 18 ka të bëjë me publikimin në një sërë mediash të skandalit të vjedhjes së të dhënave të qytetarëve

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

nga ana e partisë socialiste dhe disa artikuj të tjerë që mbështesin pikërisht këtë pretendim. Prova tjetër, që për përfaqësuesin ligjor të partisë Socialiste, që nuk pati durim të qëndrojë në sallë, e në fakt u konsiderua e panevojshme, por që për ne është shumë e rëndësishme, e që ka të bëjë me falënderimet publike që kryeministri dhe kryetari i partisë Socialiste u bënte patronazhistëve për rezultatin që kanë arritur në qarkun e Vlorës. Prova të tjera kanë të bëjnë me urdhrin e komitetit teknik të ekspertëve për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Maqedonia e Veriut dhe Greqia, si dhe vendimin për heqjen e këtij urdhri vetëm një javë pasi kishte përfunduar procesi zgjedhor. Praktika të tjera kanë të bëjnë me konstatimet tona lidhur me pavlefshmërinë e fletëve të votimit, duke filluar nga vendimmarrjet e komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të Kolegjit Zgjedhor; dhe më pas njoftimet për sa i përket numrit të fletëve të pavlefshme qoftë në rang kombëtar apo në rang qarku të Vlorës. Provë tjetër e rëndësishme në vlerësimin tonë i nderuar është deklarata e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve datë, 28.04.2021; në fakt do doja të ndalesha pak tek kjo provë, sepse besoj së është e rëndësishme edhe për proceset e tjera; u tha këtu nga anëtarë të KAS-it, një konstatim i padrejtë më herët sa i përket fakteve të përfituara nga kryqëzimi i të dhënave të pajisjes PEI, që është një kërkesë e jona edhe për qarkun e Vlorës, është kërkuar nga ana e vetëm 2 anëtarëve të KAS-it. Në fakt, e vërteta është që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, së bashku me zëvendës komisioneren, kanë njoftuar në datën 28 prill që ishte duke u kryer ky lloj kryqëzimi, pra nuk është një proces që është kryer vetëm për shkak të kërkesës së bërë nga anëtarët e KAS-it, por ishte një proces që po bëhej në funksion të mirë administrimit zgjedhor dhe ne besojmë që edhe në rastin e qarkut Vlorë është një provë e rëndësishme që kërkojmë të merret. Prova nr. 9 është audio përgjimi i drejtorit të përgjithshëm të ASHK-se, për sa i përket 160 mijë leje legalizimi dhe së fundmi i nderuar janë deklaratat publike të përfaqësuesve të partisë


*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

socialiste për sa i përket data-bazës së të dhënave personale. Tani, në qoftë se më lejoni, do të vijoj me prova që kërkojmë të administrohen në përputhje me nenin 136, pika 1, germa c, dhe nenit 137 të kodit zgjedhor lidhur me të dhënat dhe informacionet që mund të merren nga ana e KAS-it pranë institucioneve publike. Provat që ne kërkojmë të merren janë të cituara edhe në faqen 44 dhe 45 të kërkesës ankimore. Tipologjia është e njëjtë edhe me kërkesat që ne kemi bërë më herët, të cilat, në fakt në dy raste, ky komision i ka rrezuar. Shpresojmë të jetë i njëjtë rasti edhe këtë herë edhe në kuadër të asaj që tha zoti Bele për parimin e transparencës, që shpresojmë të respektohet edhe ndaj kërkesave të partisë Demokratike, dhe jo vetëm ndaj kërkesave të partisë Socialiste. Konkretisht provat që ne kërkojmë të merren janë informacion zyrtar nga prokuroria kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar për numrin e procedimeve penale lidhur me krimet zgjedhore të kryera në qarkun Vlorë dhe fazën në të cilën ato janë. Informacion zyrtar nga prokuroria e përgjithshme për numrin e procedimeve penale lidhur me krimet zgjedhore në të gjitha prokuroritë, të kryera në qarkun Vlorë dhe fazën në të cilën ato janë këto hetime. Informacion zyrtar nga drejtoria e përgjithshme e policisë së shtetit për numrin e shtetasve të ndaluar, të arrestuar apo numrin e rasteve të referuara për krime zgjedhore në qarkun e Vlorës. Marrjen e një informacioni zyrtar nga drejtoria e përgjithshme e rezervave materiale të shtetit mbi gjendjen e rezervave në depozitat qendrore dhe lokale për çdo muaj nga dhjetori 2020 deri në maj 2021. Kjo, pasi siç edhe kemi relatuar në kërkesat tona të mëparshme, ne kemi pasur referime dhe informacione të shumta që rezervat e shtetit janë përdorur për të shpërndarë ndihma ushqimore në familjet në nevojë, në këmbim të votës së tyre. Marrjen e informacioneve nga inspektorati qendror dhe të gjitha inspektoratet që veprojnë në Republikën Shqipërisë për numrin e inspektimeve të kryera brenda qarkut Vlorë në periudhën 24 dhjetor 2020 deri në 1 Maj 2021, për numrin e gjobave dhe të

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

sanksioneve të vendosura, numrin e sanksioneve dhe gjobave të revokuara qofshin këto me vendim administrativ apo me vendim gjyqësor. Marrjen e informacionit zyrtar nga agjencia e prokurimeve publike për numrin e tenderëve, koncesioneve PPP-ve, të shpallura rishtas apo për të cilat janë shpallur fituesit në periudhën e ndaluar nga Kodi zgjedhor, për periudhën 24 dhjetor 2020 deri në Maj 2021 për projektet brenda qarkut të Vlorës. Marrjen e një informacioni zyrtar nga këshilli kombëtar i territorit për numrin e lejeve të ndërtimit të dhëna në periudhën 24 dhjetor 2020 deri në 1 Maj 2021 në qarkun e Vlorës. Marrjen e një informacioni zyrtar nga ASHK-ja për numrin e lejeve të legalizimit të dhëna sipas qarqeve në periudhën 24 dhjetor 2020 deri në 1 Maj 2021, respektivisht edhe në qarkun e Vlorës. Marrjen e një informacioni zyrtar nga DPGJC për numrin e shtetasve shqiptare që ndryshuan adresat e banimit në periudhën 1 janar 2020 deri në 1 Maj 2021 në qarkun e Vlorës. Marrjen e një informacioni zyrtar nga DAP-i, për numrin e punonjësve në institucionet publike vendore apo qendrore dhe si ka ndryshuar ky numër në periudhën 1 janar 2020 deri në 1 Maj 2021. Marrjen e një informacioni zyrtar nga bashkitë e qarkut Vlorë, agjencitë e varësisë dhe shoqëritë në pronësi të shtetit apo bashkive, për numrin e punonjësve në institucionet publike vendore apo qendrore dhe si ka ndryshuar ky numër në periudhën 1 janar 2020 deri në 1 Maj 2021. Marrjen e një informacioni zyrtar nga MSHMS, në bashkitë e qarkut Vlorë lidhur me numrin e familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe si ka ndryshuar kjo masë gjatë periudhës 1 janar 2020 deri në 1 Maj 2021. Marrjen e informacionit zyrtar nga prokuroria e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar lidhur me fazën e hetimeve për bërjen publike të të dhënave të 910 mijë qytetarëve. Marrjen e një informacioni zyrtar nga INSTAT-i, lidhur me numrin e shqiptarëve që jetojnë në Republikën e Greqisë dhe të Maqedonisë së Veriut dhe konkretisht atyre që kanë të drejtë vote dhe që janë mbi 18 vjeç. Marrjen e një informacioni zyrtar nga MSHMS,

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*


lidhur me numrin e personave të infektuar me kovit 19 në datën 25 prill 2020, për qarkun Vlorë dhe konkretisht të shtetasve mbi 18 vjeç që kanë qenë me të drejtë vote. Marrjen e një informacioni zyrtar nga DP e policisë së shtetit, lidhur me numrin e shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në Shqipëri në periudhën 19 prill 2021 deri në 25 prill 2021 nga Republika e Greqisë dhe e Maqedonisë së Veriut. Marrjen e një informacioni zyrtar nga OSHEE-ja mbi të gjitha shpërblimet që i janë dhënë punonjësve të kësaj kompanie shtetërore për qarkun Vlorë, si dhe fundmi ashtu siç edhe e relatuam gjatë kërkesës tonë ankimore, marrjen e të dhënave të kryqëzuara ndërmjet pajisjeve të identifikimit elektronik PEI për zonën zgjedhore të qarkut Vlorë. Ne jemi të bindur, të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, që në qoftë së kërkesat tona do të pranohen, ashtu siç në fakt rezultoi edhe nga marrja e të dhënave të krahasuara pajisjeve PEI, do të zbardhen krime zgjedhore që faktojnë katërçipërisht masakrën zgjedhore të 25 prillit, siç edhe ka ngritur me të drejtë partia Demokratike. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Logu. Pra ju kërkonte edhe në rastin e qarkut Vlorë marrjen e informacionit për pajisjen PEI, apo jo?!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po i nderuar krahas 18 kërkesave të tjera që ne kemi për komisionin në tërësi dhe ne shpresojmë që këtë radhë të merren parasysh.

**Z. E. Lako:** Për të bërë një sqarim këtu nga dy anëtarë të KAS-it është kërkuar marrja e këtij informacioni në cilësinë e provës për pajisjen PEI, për ta administruar si provë në këtë proces. Ndërsa për sa i përket procesit që po zhvillon komisioneri, në lidhje me detyrimet ligjore për nxjerrjen e të dhënave, është gjë tjetër jashtë këtij procesi.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

Prandaj ka qenë kjo kërkesë për ta bërë pjesë të këtij procesi, sepse sipas ligjit ky informacion i nevojitet KQZ-së për ta përdorur pas përfundimit të procesit.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Qartë! Por pati pretendime nga një anëtar, që është i pa informuar, për mendimin tim, së nuk ka informacion zyrtar nga Komisioneri Shtetëror për këtë gjë, që këta janë prova që po merren nxitimthi, në mënyrë jo profesionale etj., etj. Por pretendime të tilla ...

**Z. E. Lako:** Do të kërkoj informacion nga autoritetet përgjegjëse dhe do ta sqarojmë, ... faleminderit! ...kalojmë atëherë me administrimin e provave.

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i LSI-së:** Sa i përket provave, ne i kemi depozituar fizikisht, në kërkesën ankimore dhe po i citoj; është vendimi nr. 345, datë 4.05.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; rekomandimi i avokatit të popullit nr. 242, datë 21.04.2021, pyetësori tip i MB për personat që ktheheshin nga zonat e prekura nga virusi Covid 19, dhe këtu është hilja më e madhe, për vete faktin së pyetësori i MB, i nderuar, është bërë 4 ditë para ditës së zgjedhjeve. Pse nuk u bë me datë 1 prill ose me 30 qershor?! Kjo ishte arsye e vetme se si zgjedhësve të opozitës të mos u jepej mundësi për të votuar me datë 25 prill 2021. Prova e katërt është peticioni i shoqatave të emigrantëve në Greqi; prova e pestë është letra e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nr. 1413, prot. 2 datë 22.04.2021. Faleminderit! Këto janë të gjitha provat që kemi depozituar bashkë me kërkesën ankimore.

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Në lidhje me subjektin partia socialiste, si pale e interesuar?! Po, nuk ndodhet në sallë!

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i LSI-së:** I nderuar, mundem?! Provat që kërkojmë të marrim është pajisja PEI, e cila iu shit shqiptarëve si një risi për vete faktin, së në zgjedhjet e 25 prillit 2021, ishte diçka e re në vendin tonë. Janë shpenzuar miliona Euro; ne e dimë shumë mirë së pajisja PEI ishte diçka fiktive, e cila nuk funksionoi! Funksionoi në parim por jo për të parandaluar vjedhjen dhe manipulimin e votave, dhe kërkojmë të administrohet kjo pajisje në qarkun e Vlorës. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit! E qartë! Tani ne do të ...! kërkuat kryqëzimin e të dhënave apo pajisjen?!

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i LSI-së:** Kryqëzimin e të dhënave dhe pajisjen! Për vetë faktin së ka pasur shumë qendra votimi ku pajisja PEI nuk ka funksionuar; ka pasur shumë raste në qendrat e votimit që regjistri fizik nuk ka funksionuar, i nderuar, dhe unë të jap prova konkrete, rasti tek zona e freskut, kështu që kërkojmë edhe pajisjen edhe kryqëzimin e të dhënave, për të vërtetuar së si është votuar në qarkun e Vlorës.

**Z. I. Rusmali:** Pajisjen për çfarë e kërkonti?

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i LSI-së:** Pajisjen e kërkojmë nëse pajisjet PEI kanë qenë funksionale dhe a ka pasur probleme me pajisjen PEI nga ku, nga pajisja PEI është kaluar në votimin fizik. Sepse i nderuar Rusmali, në zonën e Freskut, në momentin që kam votuar unë regjistri fizik nuk ka funksionuar dhe kjo është arsyeja që kërkojmë edhe pajisjen edhe kryqëzimin e të dhënave.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

**Z. L. Braho:** Të bëj një sqarim të vogël! Një pyetje për administratën e KQZ-së. Sa qendra votimi ka Qarku i Vlorës?!

**Z. Y. Merkaj:** Diku tek 350 qendra votimi ndoshta.

**Z. L. Braho:** Atëherë ju përfaqësuesit e LSI-së, kërkoni 350 pajisje PEI?!

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i LSI-së:** Ne kërkojmë që 350 pajisjet PEI kanë qenë funksionale apo jo? Pastaj, kërkojmë kryqëzimin e të dhënave!

**Zoti Ledio Braho:** Pra doni informacion për pajisjet!

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i LSI-së:** Po sa prej tyre kanë qenë funksionale dhe sa të dëmtuara dhe nuk kanë punuar gjatë procesit zgjedhor edhe kryqëzimin e të dhënave. Sepse, i nderuar, numri i zgjedhësve që kanë votuar janë 106664; fletë votimi të pavlefshme janë 4730; fletë votimi të dëmtuara janë 224 dhe mundësia për të votuar e zgjedhësve me pyetësorin tip të ministrisë së brendshme nuk iu dha mundësia për të votuar 208260 zgjedhësve. Kjo është arsyeja që i kërkojmë të gjitha. D.m.th., zgjedhësit që kanë votuar janë shumë më pak së zgjedhësit që nuk kanë votuar. Ky është mekanizmi që e përdori vetë MB me qëllim për të manipuluar zgjedhjet e 25 prillit. Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Një pyetje kisha unë. Me mjetet që iu njeh ligji juve, nuk e keni pasur të mundur që të identifikoni të saktë së në sa qendra votimi nuk kanë funksionuar pajisjet PEI. Ju keni pasur në mos gaboj unë, anëtarë komisioni të propozuar nga ana juaj dhe keni pasur edhe vëzhgues si subjekt zgjedhor në çdo qendër votimi. Dhe

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

bashkë me këtë të drejtë keni pasur edhe të drejtën që të merrni dokumentacionin e qendrës së votimit. E keni shfrytëzuar?! Nuk e keni shfrytëzuar dot këtë material burimor?! Apo ka humbur rrugës? Çfarë ka ndodhur?

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i LSI-së:** Nuk e kemi shfrytëzuar dot, i nderuar!

**Z. I. Rusmali:** Na e sqaroni pse se keni shfrytëzuar dot? Çfarë ka ndodhur që së keni shfrytëzuar?!

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i LSI-së:** I nderuar! Në ditën që kanë mbaruar zgjedhjet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë sa ishte përqindja e votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhje! D.m.th. në orën 7 pasdite nuk ka qenë në gjendje ta përcaktojë sa ka qenë pjesëmarrja, ...

**Z. I. Rusmali:** Fakti që në ca vende ka punuar dhe në ca vende nuk ka punuar, ... në të gjitha vendet ku ajo ka punuar dhe në të gjitha vendet ku ajo nuk ka punuar, ju keni pasur vëzhguesit tuaj me të drejtë akses në dokumentacion. Do të thotë së ata merrnin fotokopje të vendimeve, shënimeve nga libri, merrnin kopje të librit të KQV-së, këto i keni marrë këto dokumente zgjedhore? ju i keni administruar në selinë e partisë; keni nxjerrë ju nga ana juaj në sa vende ka punuar dhe në sa nuk ka punuar?! Apo nuk ju ka funksionuar skema juaj e administrimit të vëzhgimit të zgjedhjeve?!

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i LSI-së:** Jo i nderuar, nuk i kemi ndarë sa kanë punuar dhe sa jo!

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Ju si KQZ, e dispononi informacionin për qarkun e Vlorës sa pajisje PEI kanë qenë funksionale dhe sa jo, në të 445 qendrat e votimit që ka qarku i Vlorës?!

**Z. Y. Merkaj:** Po e disponojmë!

**Z. I. Rusmali:** E dispononi! Dakord!

**Z. E. Lako:** Lidhur me kërkesat e subjekteve ankues, KAS-i do të tërhiqet për vendim; kështu që do të rifillojmë në rreth 15 minuta, besoj, në orën 12:20. Faleminderit!

**Rifillon Mbledhja**

**Ora: 12:47**

**Z. E. Lako:** Zoti Ylli folët me përfaqësuesit e subjekteve ankues, po vijnë?

**Z. Y. Merkaj:** Po.

**Z. E. Lako:** KAS u tërhoq për të marrë vendim dhe me shumicë votash vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së subjektit ankues PD për marrjen e informacioneve zyrtare në cilësinë e provës nga organet shtetërore të listuara në kërkesën ankimore bazuar nën 126 të Kodit Zgjedhor;
2. Pranimin e kërkesës së subjektit ankues LSI për të marrë informacion nga Administrata e KQZ-së, për të marrë informacion sesa pajisje PEI kanë qenë funksionale ditën e votimit në Qarkun e Vlorës si dhe meqenëse dy anëtarë të KAS-it vendosën të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të kërkuar marrjen e provave nga

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2021*

KQZ për të kërkuar pra në cilësinë e provës të dhënat që do të rezultojnë nga kryqëzimi i pajisjeve PEI për këtë qark. Pra administrata të nxjerri informacionin nga të dhënat PEI për Qarkun e Vlorës për kryqëzimin e të dhënave sipas kërkesës së 2 anëtarëve. Seanca për shkak të marrjes së këtyre provave shtesë do të ndërpritet dhe seanca tjetër do të jetë nesër për orën do të njoftoheni gjatë shqyrtimit të Qarkut Berat. Zoti Sekretar i Përgjithshëm nëse keni mundësi të dhënat e kërkuara për të gjitha qarqet nga pajisjet PEI në momentin që do të jenë gati t'ju vihen në dispozicion palëve në mënyrë që mos të kemi shtyrje të procesit jo vetëm për Qarkun Vlorë por nëqoftëse kjo do të jetë një kërkesë nga subjektet dhe për qarqet e tjera t'ju vihen në dispozicion sa më shpejt në mënyrë që mos të kemi ndërprerje të procesit dhe mund t'ua vini në dispozicion palëve që mos të kërkojnë marrjen e këtij informacioni nëpërmjet KAS-it.

**Z. Y. Merkaj:** Duke qenë se jemi në procesin e thurrjes së kryqëzimit të të dhënave, kemi dhënë porosi që të gjitha kërkesat ankimore të bëhen gati sipas qarqeve, kështu që po punohet për këtë.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



20.05.2021  
Ora 11:28

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr. 36, 1.” Kundërshtimi i vendimit nr. 345, datë 04.05.2021 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Vlorë; 2. “Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021”; “Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Qarkun Vlorë” dhe nr. 49 1. “Ndryshimin e vendimit të KSHZ nr. 345, datë 04.05.2021”; 2. “Shpalljen e palefshmërisë së zgjedhjeve në të gjithë Qarkun Vlorë”, subjekti ankues PD dhe LSI”.

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PS, LSI, PD

**Z. E. Lako:** Atëherë, vazhdojmë seancën për shqyrtimin e ankimit nr.36, të subjektit ankues Partia Demokratike e Shqipërisë dhe ankimit nr.49, të subjektit ankues Lëvizja Socialiste për Integrim, me objekt kundërshtimin e vendimit nr.345, datë 04.05.2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse, për rezultatin në zonën zgjedhore, Qarku Vlorë. Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021, në këtë qark, dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Qarkun Vlorës. Gjatë seancës së kaluar, për shkak se dy anëtarë të KAS-it, kërkuan vënien në dispozicion të informacionit, që do të rezultonte pas përfundimit të procesit të kryqëzimit të të dhënave të gjeneruara nga pajisja PEI, për Qarkun e Vlorës, si dhe kërkesës që KAS-i vendosi të marrë në cilësinë e provës, në informacion lidhur me

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021**

faktin se sa pajisje PEI kanë funksionuar ditën e votimit në këtë qark. Ne e pezulluam seancën dhe e riçelëm sot, për faktin që, në dijeninë time gjatë ditës së djeshme, është nxjerrë kjo e dhënë nga administrata e KQZ-së, pra, se si ka përfunduar procesi i kryqëzimit të të dhënave të gjeneruara nga pajisjet PEI dhe në dijeninë time, palët janë njohur me këtë informacion dhe e disponojmë. Përsa i përket kërkesës tjetër të KAS-it, për marrjen e informacionit për numrin e pajisjeve PEI, që kanë qenë funksionale atë ditë në qark, zoti Sekretar i Përgjithshëm, kemi ndonjë informacion?

**Z. Y. Merkaj:** Po i nderuar anëtar i KAS-it, do të vijë shumë shpejt, është duke u printuar, vjen për pak çaste.

**Z. E. Lako:** Atëherë, ne vazhdojmë procesin, për palët në momentin që do të jetë si informacion, do t'ju vëmë në dispozicion, sepse thjesht është numri i pajisjeve që kanë punuar dhe ju mundet që gjatë seancës dhe gjatë pretendimeve mund ta plotësoni me këtë të dhënë që keni kërkuar. Apo keni ndonjë kërkesë tjetër?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** I nderuar, në qoftë se do themi, mbyllim fazën e marrjes së provave, ne do kalojmë në pretendime përfundimtare, besoj që pa ardhur prova i bie që s'mund të kalojmë në konkluzione përfundimtare, se nuk mund ta mbyllim procesin e hetimit administrativ..

**Z. E. Lako:** Po, zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Ne na ka ardhur një provë, të cilën mund ta marrim në shqyrtim, palët janë njohur me të dhe mund të reagojnë rreth provës, kështu që ne mund të zhvillojmë punën tonë.

**Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. E. Lako:** Faleminderit, kjo ishte dhe ideja, ndërkohë mund të vijë dhe e dhëna.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po, është shumë e saktë ajo që tha zoti Rusmali, ne kemi një provë, të themi, që është përplasja e të dhënave nga PEI, kjo është kërkuar në ditët përpara se të kërkohej dhe prova e dytë, e cila do të duhet të ishte në disponimin tonë sot, por nuk e kuptojmë sekretarin e Përgjithshëm, pse nuk na e ka vënë në dispozicion, gjithsesi të debatojmë mbi këtë provë, në qoftë se KAS është dakord dhe pastaj të vijojmë me pretendimet përfundimtare.

**Z. E. Lako:** Po, vazhdoni zoti Kaziaj!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Qoftë dhe nga një shikim i përciptë, të themi, i materialit të vënë në dispozicion. drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, që ka të bëjë me kryqëzimin e të dhënave të identifikimit elektronik për Qarkun Vlorë, ashtu siç kemi hasur dhe në materialet e ngjashme për qarqet e tjera, që ishte Berati dhe Gjirokastra, shohim raste të dyshimta. Them i dyshimta se zoti Rusmali dje ia bëri pyetjet, të themi përfaqësuesve të KQZ-së, Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve dhe personit përgjegjës që merret me PEI-n në KQZ. Thuhet të dyshimta, për shkak se vetë terminologjia e përdorur nga makineta është e tillë, që thotë *suspect cases*, dhe këtu në këtë rast shohim që dy shenja gishti janë depozituar, domethënë, kjo shenjë gishti, thuhet diku nga pjesa e fundit e shkresës, në faqen e parë, “dyskohet se një shenjë gishti është depozituar në dy raste”. Kjo është nga anomalitë e para, po ashtu në qoftë se shkojmë në fjalinë e parafundit, të faqes së parë, thuhet që, “në rastin e shenjës së gishtit me numër 27 46 806, dyskohet se e njëjta shenjë gishti është depozituar në PEI, në qendrën e votimit

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

4672 gjatë leximit të 12 dokumenteve të identifikimit”. Kjo është një e dhënë që duhet mbajtur parasysh administrativisht nga ana e KAS, por duhet të jetë dhe në vëmendje të organit procedues, të themi, lidhur me verifikimet e mëtejshme të përgjegjësive personale ose kolektive të personave që kanë tentuar ose që kanë arritur qëllimin e kryerjes së votimit, me 12 dokumente identifikimi, të themi, nëpërmjet një shenje gishti. Tabela është shumë e qartë, ka të dhëna të mjaftueshme dhe për ju si komision dhe për organin procedues, me inicialet e emrit, mbiemrit, me datëlindjen e personave, me QV-të ku janë votuar, me ZAZ-të përkatëse dhe me shenjën e gishtit, me numrin rendor përkatës. Ky është një shqetësim që ne po e hasim nga këto materiale që na vihen në dispozicion, me kërkesë tuajën ose me kërkesë të subjekteve për shumë zona zgjedhore dhe shumë qarqe, ashtu siç është një shqetësim tjetër që unë dua ta bëj publik, i cili na ka ardhur vetëm në mëngjesin e ditës së sotme, që ka të bëjë me QV 4276, në ZAZ-në 82 në Dropull, ku kemi informacion, që një person ka votuar për 12 persona të tjerë, në atë qendër votimi.

**Z. I. Rusmali:** Kjo është gjë tjetër!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** E di zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Ne kemi Vlorën sot!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ju jeni të ngarkuar me detyrë të posaçme, në qoftë se lodheni nga një fjali e një subjekti politik!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Detyra e posaçme është shqyrtimi i kërkesës ankimore të Vlorës. Informacioni për zona zgjedhore të tjera, është i panevojshëm për këtë seancë, mund të jetë i rëndësishëm për publikun, por mund të shfrytëzoni mjete të tjera për...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po si qytetar i Republikës, është i rëndësishëm?

**Z. I. Rusmali:** Unë jam anëtar i KAS-it. Si qytetar i Republikës unë ndjek me shumë vëmendje konferencat tuaja të shtypit. Shumë e thjeshtë!

**Z. E. Lako:** Zoti Kaziaj, ju lutem vazhdoni me provën dhe të përqendrohemi tek objekti!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** E shoh që është një shqetësim për zotin Rusmali, është një shqetësim kur denoncohen këto fakte me indicie të caktuara nga zoti Rusmali nuk e di pse na fsheh gjithmonë diçka...


**Z. I. Rusmali:** Është shumë e thjeshtë, është disiplinë pune, është rregullore dhe rregullat janë shpikur që njerëzit t'i zbatojnë. Kaq e thjeshtë është gjëja. Seanca ka rend dite dhe rendi i ditës duhet respektuar. Është shumë e thjeshtë.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Për procedurë, nga ana e interesit madhor që ka një subjekt politik, mund ta thotë dhe diçka që s'ka të bëjë me rendin e ditës. Faleminderit, gjithsesi mbarova, kaq ishte relatimi im për këtë pjesë zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Po, por na vonove 5 minuta me këtë çështje jashtë temës.

*Zbardhi materialin audio*

*Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Kjo është çështje madhore që duhet të jetë dhe në interesin tuaj personal.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Kaziaj! Atëherë zoti Logu?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po, faleminderit i nderuar! Kjo është në fakt një provë, e cila u kërkuar nga Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim që të merret nga ana e KQZ-së, krahas dhe 19 kërkesave të tjera për prova që do bënin transparencë të plotë, mbi atë se çfarë ka ndodhur në zgjedhjet e 25 prillit në Qarkun e Vlorës. Nga kryqëzimi i të dhënave, pajisje PEI, dhe informacioni që na është vënë në dispozicion, rezulton se shenjat e gishtërinjve të 23 personave janë përdorur për identifikimin e 60 zgjedhësve në Qarkun e Vlorës. Kjo do të thotë se ekziston mundësia që 23 persona të kenë votuar 60 herë ose rreth 3 herë secili. Kjo ishte në fakt dhe një pyetje që iu bë dje, Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve nëse, sipas këtyre të dhënave, ekziston mundësia që një person të paraqitet një, dy apo 12 herë, siç është njëri nga rastet për shenjën e gishtërinjve, me numër rendor 21 që gjeni në tabelën bashkëlidhur, dhe përgjigja ishte se, po, ekziston si mundësi. Në fakt përveç këtij konkluzioni, po themi ose kësaj gjetjeje të përgjithshme, ne mendojmë që ka së paku dhe tre gjetje të rëndësishme që ka nevojë të shikohen me vëmendje nga ana e palëve, por edhe nga ana e anëtarëve të KAS-it. Në qoftë se vërejmë shenjën e gishtit me numër rendor nr.7, do të shohim se kjo shenjë gishti është përdorur për identifikimin e dy zgjedhësve në dy qarqe të ndryshme. Njëra në Bashkinë Vlorë dhe tjetra në Bashkinë Ura Vajgurore në Berat. Pra, i njëjti person ka përdorur shenjën, për identifikimin elektronik, shenjën e tij të gishtit, njëherë në Qarkun Vlorë dhe një herë në Qarkun Berat. Ndërkohë që me numër rendor nr.19, shohim se i njëjti person me inicialet G.B. ka votuar një herë në Bashkinë Konispol, dhe një herë tjetër ka votuar në Bashkinë Sarandë, që është një rast i pastër i votimit

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

të dyfishtë. Po ashtu, po të shohim shenjën e gishtit me numër rendor 21, shohim se kemi të bëjmë me një person që ka vendosur shenjën e gishtit të tij për identifikimin e zgjedhësve që në vlerësimin tonë, do të thotë që ekziston mundësia, ose potencialisht ky person ka votuar 12 herë. Këto janë 3 gjetjet, të cilat ne i konsiderojmë të rëndësishme, por sigurisht në tërësinë e saj kjo provë është e rëndësishme për këtë proces zgjedhor, prandaj do të kërkonim nga ana juaj që në tërësinë e shkeljeve të ligjit, që janë parashtruar nga ana e subjekteve ankuese se Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim dhe Lëvizja Socialiste për Integrim të merreshin parasysh edhe të dhëna që na vijnë nga kryqëzimi i të dhënave PEI, që dëshmojnë qartazi për raste të votimit të shumëfishtë. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Logu! Të mbaronim, por pala e interesuar nuk është përfaqësuesi në seancë, kështu që, përderisa nuk është, po zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit! Unë kisha një pyetje për zotin Logu! Ju thatë që ekziston mundësia që, mos m'i merrni për kapital shifrat, 23 persona të kenë votuar 16 herë ose anasjelltas, 23 persona të kenë votuar 60 herë. Në gjykimin tuaj, kjo provë që na është servitur, a provon se 23 persona kanë votuar 60 herë?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Rusmali, për të gjitha pyetjet tuaja unë kam disa përgjigje.

**Z. I. Rusmali:** Njërën!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Përgjigjja ime e parë për ju është: Pse ju keni refuzuar të merrni prova nga SPAK-u për rastet e shit-blerjes së votës në Qarkun

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

Vlorë? Përgjigjja ime e dytë është. Pse ju zoti Rusmali refuzoni të merrni informacion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për lejet e legalizimit në Vlorë? Pyetja ime ose përgjigjja ime nr.3 për ju është. Pse ju refuzoni të merrni informacion nga agjencitë shtetërore në Qarkun e Vlorës, sa është numri i të punësuarve? Dhe kam shumë pyetje të tilla që janë përgjigje, por a mund t'i përgjigjeni pyetjeve?

**Z. I. Rusmali:** Në rregull i përgjigjem unë, por të gjitha këto dhe për 18 pyetjet që keni ju, se më duket 18 janë, 19 pyetje, ju do keni një përgjigje të saktë dhe precize në vendimin e KAS-it, se ne flasim, përgjigjet i japim me vendim. Çështja është që ju u përgjigjët në seancë dhe mua më duhet, po të doni thoni refuzoj përgjigjen se nuk ju marrim ne në përgjegjësi për këtë punë. Mua më duhet gjykimi juaj që unë të gjykoj pastaj. Në gjykimin tuaj, kjo provë që na është servirur, a e provon se 23 persona kanë votuar 60 herë, po apo jo?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** E kuptoj, pra zoti Rusmali ju nuk keni përgjigje për 19 kërkesat tona, nuk keni, s'ka gjë po ju përgjigjem unë!

**Z. I. Rusmali:** Kam një përgjigje precize, me vendim për këtë punë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po ju përgjigjem unë, nuk keni përgjigje, është e qartë, nuk doni...

**Z. I. Rusmali:** Me vendim dhe mund edhe të habitesh zoti Logu!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Nuk do habitem aspak! Nuk habitem nga vendimmarrjet tuaja.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë je njeri i fortë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Vendimmarrjet tuaja janë shumë të parashikueshme, i lexoj çdo natë në media.

**Z. I. Rusmali:** Do japësh përgjigje, sepse është një proces serioz!


**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Më lejo ta jap përgjigjen!

**Z. I. Rusmali:** Prit sepse dua ta precizoj pyetjen!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Nuk ka nevojë ta sugjestionosh pyetjen! Më lër të ta jap përgjigjen ashtu siç e mendoj unë! Atëherë zoti Rusmali, ju ishit dje i pranishëm në këtë seancë dhe unë e pyeta Nënkomisioneren Shtetërore të Zgjedhjeve se as unë dhe as ju nuk jeni ekspertë të teknologjisë, fatmirësisht apo fatkeqësisht. A ekziston mundësia, i thashë, që në bazë të të dhënave që na keni sjellë për Qarkun e Gjirokastrës, por për analogji dhe për Qarkun e Vlorës, që një person të ketë me vete 19 karta identiteti, sepse ishte rasti që kishim 19 raste, të paraqitet në një qendër votimi, të bëjë leximin e këtyre 19 kartave të identitetit, të vendosë shenjën e gishtit të tij dhe më pas të votojë 19 herë? Përgjigja e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve, e organit kompetent për të dhënë këtë përgjigje, që s'jeni as ju e as unë, ishte: "Po, ekziston mundësia!" Kështu që zoti Rusmali, përgjigja për pyetjen tuaj është si e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve: "Po ekziston mundësia, kjo provë e thotë këtë gjë!" Në qoftë se ju doni pastaj që kjo gjë të zbardhet deri në fund, ky është një proces penal që i takon Prokurorisë dhe as ju, as unë nuk mund të marrim kompetencat e prokurorëve në këtë proces.

**Z. I. Rusmali:** Atëherë që të kuptojmë qartë përgjigjen e pyetjes. Dua ta kuptoj qartë. Ju thoni, sikurse dhe nënkomisionerja, ekziston mundësia që të ketë ndodhur ky

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

skenar, por prova nuk provon se ka ndodhur ky skenar. Se në qoftë se prova do provonte se ka ndodhur ky skenar, ju do të ishit njeriu më i lumtur në botë dhe do kërkonit fjalën me nxitim, do më ndërprisnit fjalën mua dhe do thonit, shikoni provën, kjo provë tregon se ka ndodhur ky skenar! Ju këtë privilegj nuk e keni.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** E thamë! Atëherë zoti Rusmali, ju dokumentoni përgjigjen...

**Z. I. Rusmali:** Të lutem, unë nuk të ndërpreva!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** E dëgjova komentin tuaj!

**Z. I. Rusmali:** Unë nuk të ndërpreva, unë nuk po bëj më pyetje!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Unë jam këtu, mos më citoni mua duke keqpërdorur fjalën time!

**Z. I. Rusmali:** Unë nuk po bëj më pyetje!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Mos e keqpërdorni fjalën time!

**Z. E. Lako:** Zoti Logu ju lutem, të respektojme radhën dhe palët pjesëmarrëse. Do ju jepet mundësia që ta sqaroni përsëri!

**Z. I. Rusmali:** Ka një gjë që besoj edhe fëmijët e marrin vesh. Ju keni ardhur në këtë institucion që të kërkonit drejtësi. Drejtësia kërkohet duke mbajtur në njërin dorë ligjin, në dorën tjetër provat dhe ju i drejtoheni institucionit me ligjin dhe me provat dhe beteja e palëve në një trup si kjo e jona, si edhe në gjykata, është gjithmonë, ku cila palë ka argumentin më të fortë, më të bazuar, më të qëndrueshëm për të bindur trupën. Në qoftë se vihet me argumentin, cila palë mund të silltet keq me anëtarët e

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

trupës, mund të sillet pa edukatë, mund t'i konfrontojë, mund t'i kanosë, mund t'i shajë publikisht, njerëzit që vijnë me këtë qëndrim nuk kanë kuptuar mënyrën si funksionon shteti, drejtësia dhe ligji. Pyetjet unë nuk i bëj për karshillëk, asnjërin nga pyetjet që kam bërë në të gjitha seancat që kam bërë, asnjërin për karshillëk. Nuk bëj asnjë pyetje për të atakuar asnjërin nga interlokutorët, pyetjet unë i bëj për të kuptuar raportin e provës me ligjin. Dhe është vendimtare në një provë si kjo që na është servirur, ne të kuptojmë vlerën provuese të saj. Fjalìa, a ekziston mundësia, bën fjalë për një hipotezë. Ne nuk na duhen hipoteza, na duhen prova dhe prandaj ka shumë rëndësi dhe unë bëj maximumin për të ndihmuar palën që ngre hipoteza, që t'i them, ju lutem shumë, më filtroni çfarë është provë nga dokumenti se mua më duhen provat, nuk më duhen hipotezat, dhe kjo është shumë e rëndësishme. Dhe unë evidentova përgjigjen tuaj, e plotësova përgjigjen tuaj vetëm për këtë fakt, që të gjithë njerëzit që e ndjekin, por nuk kanë mundësi ta kuptojnë dialogun, për shkak se dialogu kapërcen kufijtë e etikës, të kuptojmë faktin se kufijtë e etikës kapërcehen sepse nuk kemi dëshirën të themi fjalinë: Kjo provë mungon në dokument! Kaq është e gjitha! Pjesa tjetër bëhet thjesht për të krijuar tymnajë, ndërkohë që fakti është, hipoteza e ngritur nga zoti Logu, nuk formon provë. Provë formon vetëm fjalìa, po dokumenti provon që 23 persona kanë votuar 60 herë. Këtë fjali, fjali pohuese, e thjeshtë apo jo, shumë e thjeshtë! Zoti Logu nuk e thotë dot sepse dokumenti nuk e provon këtë gjë. Kaq është e gjithë historia. Tani për ilaritet, për konfuzion, për të prishur seancën, ju sigurisht mund të bëni shumë veprime, dhe mund të bëni shumë gjëra nga këto.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. E. Lako:** Po, zoti Logu të lutem shkurtimisht për pjesën më të madhe të pyetjeve dhe të sqarimeve lidhur me sistemin.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Më fal zoti Lako, se këtu duhet të jemi të gjithë të barabartë edhe ne këtëj edhe ju atje, duhet të jemi të barabartë me fjalën.

**Z. E. Lako:** Këtë seancë e drejtoj unë, ju lutem në lidhje me këtë argument patëm dje Nënkomisioneren që u përgjigj me qetësi të gjitha pyetjeve. Ne nuk jemi këtu për t'i bërë gjyqin as Nënkomisioneres, as prokurorit, ne jemi këtu për t'i dhënë disa përgjigje sa të mundemi palëve, provat e paraqitura ju lutemi, sa më pak replika, t'i evitojmë sa më shumë sepse nuk janë në dobi të procesit. Po ju e keni fjalën!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po, faleminderit zoti Lako. Çdo leksion mbi shtetin, demokracinë, rregullat, ligjin, sigurisht që është i mirëpritur. Po për sa kohë personi që e bën leksionin, është shembulli më i keq i sjelljes së keqe i intimidimit, i kërcënimit i sharjes që bëhet.

**Z. E. Lako:** Ju lutem zoti Logu, nuk ka nevojë shumë. Në lidhje me provën.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Pse nuk e ndaluat zotërinë që po fliste për sjellje etike, për ligjin, për moralin? Po, më ndaloni mua?

*Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. E. Lako:** Po, fliste për etikën për moralin.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po, pra dhe unë dua të bëj leksionin tim për ligjin, për etikën, për moralin! Besoj se e bëj më mirë se zoti Rusmali, faleminderit. Pra, një person që është e kundërta e asaj që na u përklamua dhe që na u shpjegua këtu, besoj që nuk e ka po themi tagrin për të bërë leksione etike apo leksione morale. Unë e kuptoj shumë mirë edhe në seanca gjyqësore dhe në seanca të këtij karakteri kur ka anëtarë, të cilët nuk përpiqen që të zbardhin të vërtetën, por përpiqen që t'i shërbejnë argumentave të njëanshme, të cilat i kanë përklamuar më herët në mjedise të tjera. Kjo nuk ka rëndësi! Kjo provë të nderuar që ne kemi këtu, është shumë e qartë është e bardha, është e zeza mbi të bardhë. Duhet lidhur dhe duhet parë sigurisht, duhet parë ngusht me ato që thoshte Nënkomisioneria Shtetërore e Zgjedhjeve, se e thamë dhe e rithamë, se ne nuk kemi ekspertët teknik të kësaj çështje. Pra, 23 zgjedhës në Qarkun e Vlorës ja kanë vendosur shenjat e gishtërinjëve të tyre, për të identifikuar 60 votues. A është kjo të nderuar anëtarë të KAS-it, shkelje e ligjit?! Pra, a e lejon ligji, a e lejon ndonjë akt nënligjor, që 23 persona të vendosin shenjën e gishtit të tyre për 60 votues? Ne e dimë që është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore. Në qoftë se ju e dini ndryshe, le të na e thoni këtu, s'ka nevojë për vendim le ta kuptojmë që tani, në qoftë se duhet të shpreheni me vendim, nëse nuk e thoni dot edhe këtë do kemi mundësi ta shohim. Potencialisht dhe sigurisht të themi unë nuk mund të dal, po themi sot garantë pra, vetëm mbi mundësinë ne mund të diskutojmë në këtë moment, ekziston mundësia që më pas këta persona janë identifikuar për 600 votues edhe të kënë votuar për këta 60 votues! Po kjo të nderuar në këtë faze, nuk ka rëndësi sepse kjo është ajo që kjo provë na thotë ne është që këtu, kemi të bëjmë më një shkelje ligji, kemi të

*Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021**

bëjmë me një parregullsi që cenon rëndë procesin zgjedhor. Për këtë ju jeni të thirrur dhe jeni të investuar nga palët. Pastaj se kush kanë qenë personat, çfarë kanë berë personat, çfarë bëjnë akoma ato me jetën private dhe kështu me rradhë, të cilat mund të jenë në interes të ndonjë anëtari të KAS. Kjo është një çështje që i takon Prokurorisë ta hetojë dhe Gjykatës më pas ta gjykojë! Kjo është, po themi, ajo që ne duam të kokludojmë mbi këtë provë dhe mendojmë që e provon katërcipërisht atë që ne kemi kërkuar dhe është arsyeja pse unë kërkoja që të futej teknologjia në këto zgjedhje.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, zoti Logu. Po, zoti Braho!

**Z. L. Braho:** Zoti Logu, që ta kuptojmë të qartë, ju jeni të idesë që kjo provë krijon dyshimin e arsyeshëm që 23 persona mund të kenë votuar për 60 persona dhe në qoftë se kjo provë lexohet së bashku me provat e tjera që ju keni paraqitur, unë do arrija në përfundimin që jemi në kushtet e pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Kjo është ajo që pretendoni nëpërmjet kësaj prove!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Kjo është i nderuar, pra kjo provë provon që në qendrat e votimit të Qarkut Vlorë, ka pasur një sërë parregullsish, të cilën sapo e shpjeguar që e parë e lidhur dhe me të gjitha shkelje të tjera, të cilat në vlerësimin tonë janë të mjaftueshme për të konkluduar mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve në Qarkun Vlorë dhe përsëritjen e zgjedhjeve.

**Z. I. Rusmali:** Por, nuk provon që 23 persona kanë votuar për 60 persona? Po apo jo?

**Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci**




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po a është shkelje e ligjit të vendosësh shenjën e gishtit për dikë? Po apo jo?

**Z. I. Rusmali:** Dakord, do të shpjegoj edhe procedurën se si ne i japim qëndrimet tona! Qëndrimet tona ne i japim vetëm pasi ne dalim nga dhoma e këshillimit dhe vetëm si trup. Në qoftë se unë qëndrimin tim do ta shreh në mënyrë të njëanëshme dhe do të përpiqem që të përfshij dhe trupën tek qëndrimi im do të thotë që unë jam duke abuzuar me funksionin që kam. Prandaj unë nuk mund të shrehem përpara se sa të merret vendimi. Do shprehem kur të merret vendimi dhe nëpërmjet vendimit, unë kuptova shumë qartë kontekstin, me të cilin ju kërkoni ta fusni provën dhe e kuptoj dhe e mbajta shënim këtë kontekst. Unë kam një dilemë me deklarimin tuaj rreth ekzistencës së mundësisë. Fjalinë për ekzistencën e mundësisë, unë duhet ta alokoj diku, është provë apo është hipotezë? Që unë të kuptoj deri në fund që deri ku shkojnë pretendimet tuaj! Prandaj bëhet pyetja provon apo nuk provon? Kuptova që ju e vendosët diku në një pozicion të caktuar këtë dokument, por nuk përfshitë atë që thatë në séance, besoj unë apo jo? E përfshitë dhe historinë që provon hipotezën tuaj?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Për ne me qenë se ju nuk shpreheni se doni të shpreheni në vendim është e qartë të themi, që qoftë edhe fakti që ka njerëz që e vendosin shenjën e gishtërinjve të tyre, për zgjedhës të tjerë përbën një shkelje të ligjit që cenon procesin zgjedhor. A jeni ju i interesuar për ta ditur se çfarë ka ndodhur konkretisht në qendrat e votimit? Ju ftoj si qytetar apo si anëtar të KAS që të bëni kallëzim penal, prisni hetimet e prokurorisë, merrni informacionin që ju refuzoni dhe të jeni i bindur që kështu do të bëhet.

*Zbardhi materialin audio  
Alban Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Shiko unë jetoj vetëm për seancën nuk jetoj për më gjatë. Mua më duhet vetëm për seancën.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ne jetojmë më gjatë zoti Rusmali në këtë vend, se jemi dhe më të rinj ndoshta!

**Z. I. Rusmali:** Me siguri do t'i dilni mbanë të gjitha sfidave tuaja.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Jam i bindur.

**Z. I. Rusmali:** Me siguri do t'i dilni mbanë, çështja është se për seancën për aq sa më duhet praktikisht, më duket se ramë dakord që hipotezën nuk e provon apo jo?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Jo, nuk ramë dakord aspak. Ne nuk biem dakord aspak me dikë që refuzon të zbardhë të vërtetën!

**Z. I. Rusmali:** Në vlerësimin tuaj për hipotezën?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Në vlerësimin tonë, ka 23 persona qytetarë, të Qarkut të Vlorës, që kanë pasur në dispozicion të tyre, 60 karta identiteti dhe për këto 60 karta identiteti kanë vendosur shenjat e tyre të gishtërinjve dhe ekziston mundësia reale, në qoftë se ju doni ta zbardhni të vërtetën drejtohuni

*Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

Prokurorisë, se ai është organi kompetent se ne jemi parti politike nuk bëjmë hetime.

**Z. E. Lako:** Zoti Logu, sqarimet i bëri dje Nënkomisioneria për sistemin. Ju lutem përmbahuni pretendimeve dhe kërkesave që ju keni!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po pra po zoti Rusmali kërkon ta tejzgjasim për të njejtat gjëra që u thanë 100 herë.

**Z. I. Rusmali:** Ja një sekondë, të përmbyll gjënë, është e vërtetë që po diskutojmë provë, vlerën e provës, është e vërtetë që ne këtë natyrë prove e diskutuam dje me një statistikë tjetër, jo me këtë statistikë. Por debati është i njejtë diskutimet dhe dilemat janë të njëjta. Debati fillon me historinë e faktit nëse rastet janë dyshime apo janë vërtetësi dhe debati ngelet për të gjitha palët sa kohë që dokumenti ngelet, sa kohë që në dokument themi, dyshohet pasi ky është rezultati që prodhon automatikisht sistemi elektronik i krahasimit të shenjave të gishtërinjëve në këtë rast. Nëse do të ishin të përputhura, pra e njëjta shenjë gishti sistemi i nxjerr të përputhura kur është rasti. Ky është sqarimi që na jepet ne, që duhet të gjykojmë nga ana e KQZ dhe ky sqarim është i rëndësishëm për ne për të gjykuar. Ky sqarim shoqëron të gjithë dokumentet dhe praktikisht të gjitha të dhënat dje për një zonë tjetër, janë të vlefshme dhe për këtë zonë pavarësisht se tabela ndryshon. Sigurisht që unë besoj që kam aq inteligjencë pavarësisht se kolegu Logu ka dyshime të mëdha për inteligjencën time! Që të kuptoj që hipoteza që zoti Logu thotë këtu dhe në media që rezulton e provuar dhe për të nuk rezulton e provuar. Hipoteza dhe pas këtij dokumenti ngelet

*Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

hipotezë. Sepse, zoti Logu me shumë dashamirësi më ftoj që të jetoj përtej kësaj seance dhe të ndjek Prokurorinë nga pas kur Prokuroria ta gjej, është e vërtetë apo është gënjeshtër kjo punë! Nuk e di do ta kem shansin të shkoj mbas Prokurorisë, shpresoj të jetoj përtej kësaj seance dhe ta mësoj një ditë këtë gjë!

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Rusmali, ju lutem zoti Logu nëse ka diçka, nuk ka replikë përmbi replikë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Lako, kjo nuk është balancuar, mos e lejoni asnjërin nga palët.

**Z. E. Lako:** Keni diçka në lidhje me provën?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po, patjetër për provën se këtu s'do flasim në lidhje me inteligjencën e zotit Rusmali as për jetëgjatësinë e tij në lidhje me provën.

**Z. E. Lako:** Në lidhje me proven, po!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ajo që ne e konsiderojmë të rëndësishme për këtë proces, është shifra 23, 60, 23 nënshkrime për 60 zgjedhës! E faktuar dhe e provuar nga shkresa zyrtare e KQZ-sw.

*Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. E. Lako:** Po, faleminderit. Zoti Kaziaj!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Atëherë këtu bëjnë debat midis një anëtari të KAS dhe përfaqësuesit të PD-sw që unë jam normalisht të themi me tezën dhe me provat që kemi, që janë shumë të qarta. Me sa shoh zoti Rusmali nuk e ka të qartë këtë provë dhe për këtë i bën pyetjet.

**Z. I. Rusmali:** Më fal, të lutem që të mos keqkuptoheni, unë provën e kam shumë të qartë, unë kisha një dilemë dhe doja të kuptoja një fjali të zotit Logu prandaj bëra pyetje specifike. Fjalja e zotit Logu nuk është në dokument apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** E sqaruat besoj!?


**Z. I. Rusmali:** Mos dil në konkluzione që është e paqartë për mua.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo unë dal në disa kokluzione të tjera që janë të karakterit të vullnetit tuaj për të mos bërë gjërat, që do me thënë, ju jeni një anëtar i KAS që keni të gjithë tagrin ligjor për të thelluar një proces hetimor.

**Z. E. Lako:** Zoti Kaziaj, nuk jeni këtu për të bërë vlerësimin e punës, të cilido anëtar i KAS! Ju lutem shprehuni mbi provën. Nuk ka lidhje prova me vlerësimin që i bëni ju një anëtar i KAS.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ju nuk e dini se çfarë do them zoti Lako, ju lutem më lejoni të mbaroj fjalinë, se mbase e hoqët nga konteksi dhe po e

*Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021**

përdorni. Pra nuk ju ndalon askush që të bëni një hetim të thelluar të karakterit administrativ. Nuk po them që ju të bëheni prokuror dhe të vini të merrni në përgjegjësi penale ju dhe të gjithë anëtarët e tjerë. Ju mund të bëni kallzime në qoftë se keni dyshime, kjo është e drejta juaj si qytetar dhe si anëtar të KAS. Po pjesën e provueshmërisë të një dileme që ju keni lidhur me një material, i cili na është sjellë nga administrata juaj, sepse dhe ju jeni pjesë e KQZ-së dhe ju e dini shumë mirë që në vërtetësi të kësaj, të këtij materiali ju mund të konsultoheni dhe me pamjet filmike të vëna për herë të parë për çdo qendër votimi për 5199 qendrat e votimit në Shqipëri. Lidhur me problematikat që hasen në materialet që na sjellë Nënkomisioneria, përse i përket pjesës së kryqëzimit të të dhënave PEI. Kush ju ndalon juve të merrni pamjet filmike të shikoni, se cili person se ka ndodhur realisht? Kush ju ndalon juve të merrni dhe të bëni çdo hetim tjetër të karakterit administrativ për të qartësuar atë që do të jetë vendimmarrja juaj? Siç e thatë juve që do shpreheni me vendim që mendimi juaj, dhe vendimi juaj të jetë gjithë përfshirës dhe pasi ju.

**Z. E. Lako:** Zoti Kaziaj vlerësimin e provave që i nevojiten KAS, e bën KAS, ju lutem na thoni diçka meqë e morët fjalën mbi vlerësimin e kësaj prove që pak a shumë. Nuk mundet të na sqaroni juve se çfarë provash do të marrim ne apo jo! E vendosim ne këtë punë.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo, jo unë sqaroj ligjin.

**Z. E. Lako:** Po, patjetër pra brenda ligjit.

**Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci**





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Zoti Lako të lutem jeni relator i kësaj seance, unë ju respektoj siç respektoj të gjithë anëtarët e tjerë. Po të lutem unë as nuk po dal nga konturet e etikës duke etiketuar, duke bërë, unë thjesht po i përmbahem një pjese të një interesi të ligjshëm, mbi baza të provueshmërisë dhe të indicieve që na kanë ardhur përpara. Duke ju thënë që nuk po ju kërkoj juve se si të bëni detyrën tuaj. Nuk do isha në ato kushte, nuk do e bëja kurrë atë gjë. Ju e dini shumë mire, se siç mund ta bëni detyrën tuaj, pavarësisht se ne do ta kundërshtojmë bërjen e saj nëpërmjet vendimit apo jo. Fakti është që në të mirë të procesit, asnjë gjë nuk ju ndalon të bëni një hetim të thelluar, të dilni në një konkluzion që doni, të pyesni personat përgjegjës, të merrni pamjet filmike. Çfarë ju ndalon? Për ne kjo provë është e qartë ashtu si tha zoti Logu, janë të qartësuar dhe të renditura në tabelë të gjitha shkeljet dhe duhet marrë, duhet administruar dhe duhet fillimisht kuptuar si provë pastaj arsyetuar mbi të, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Në dijeninë time zoti Rusmali e kërkoj këtë në sencën e kaluar dhe ju nuk e mbështetët.

**Z. L. Braho:** Ishte gjë tjetër ajo.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Çfarë nuk mbështetëm i nderuar?

**Z. E. Lako:** Për të gjetur, se cili ishte personi që potencialisht...

*Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Ishte për hetim të thelluar por s'ka rëndësi!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ta bënte atje ishte e qartë, e thënë dhe nga Nënkomisioneria, ne thamë që atje ishte përgjegjësi penale, nuk ishte përgjegjësi e zotit Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Mirë, dakord. është mirë të mos devijojmë, të mos dalim nga rendi i ditës.


**Z. E. Lako:** Në lidhje me provat, keni diçka? Na u vu në dispozicion një tabelë, ju lutem sekretar i Përgjithshëm, na e sqaro pak të lutem çfarë ka se nuk po e kuptoj dot?

**Z. Y. Merkaç:** Ju kërkoj ndjesë, por për shpejtësi të kohës është pa kokën orientuese tabela. Këtu janë të gjitha paisjet PEI, që kanë funksionuar ditën e votimit, datë 25 Prill. Janë gjithsej 407 pajisje, domethënë në 407 qendra votimi kanë punuar me pajisjen PEI dhe janë 38 qendra votimi, qendra votimi që nuk ka punuar pajisja PEI.

**Z. I. Rusmali:** Cilat nuk janë këtu?

**Z. E. Lako:** Atëherë, në lidhje me sa shpjegoj sekretari i Përgjithshëm, palët kanë ndonjë koment, ose kërkojnë ndonjë sqarim të mëtejshëm? Janë 407 pajisje

*Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021**

PEI gjithësej nga të cilat 38 nuk kanë punuar. Më fal, 407 kanë punuar, 38 nuk kanë punuar.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Siç e thatë dhe ju zoti Lako, ne shikojmë një tabelë këtu vetë, me dy ndarje, dy kolona nuk ka asnjë lloj shpjegimi, të themi materiali, fakti është se këto 38 pajisje që nuk kanë funksionuar. Nuk kanë funksionuar që nga ora 07:00 kur është hapur procesi i votimit? Apo është bërë pezullimi i tyre nëpërmjet vendimarrjes të KQV? Kërkesa për zëvendësim të saj, më pas pezullimi i procesit për 3 orë dhe vazhdimi i procesit manualisht? Çfarë historiku kanë këto 38 pajisje PEI?

**Z. E. Lako:** Po, Faleminderit. Përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Jam dakord, po themi me pyetjet që ngre kolegu i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim. Këto që këmi ne këtu në fakt nuk na thonë asgje, janë thjesht disa qendra votimi të numërtuara. Nuk i përgjigjet, po themi këkesës.

**Z. E. Lako:** U sqarua nga Sekretari i Përgjithshëm, që tabela nuk është e plotë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Atëherë le të njihemi pak ndoshta me këtë provën e re dhe të mbajmë një qëndrim.

**Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. L. Braho:** Altin, pse kërkesa juaj ishte sa kanë punuar, sa nuk kanë punuar? Në qoftë se deshe sqarime shtesë, mund të kishe bërë pyetjen këto që nuk kanë punuar pse nuk kanë punuar, s'kanë punuar gjithë ditën, gjysmën e ditës? Se tani çdo provë duhet në këtë fazë.


**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ja pra zoti Braho, ne na sollët një material që ju dilnit dot në konkluzione me këtë material të sjellë? I cili thotë po, jo, po, jo.

**Z. L. Braho:** Në kokluzion dilni ju! Se çfarë doni të arrini të nxirrni nëpërmjet kësaj prove! Ne me provën kuptojmë që, në Qarkun e Vlorës diku tek 8 apo 9% e qendrave të votimi, ditën e zgjedhjeve kanë funksionuar pa identifikimin biometrik.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po, pra dhe unë e bërë pyetjen shumë të saktë në të mirë të procesit, në të mirë të akteve të procesit të votimit. A ka funksionuar apo nuk ka funksionuar nga ora 07:00 dhe pse nuk ka funksionuar? A është bërë e gjitha, të themi procedura e pezullimit e rimarrjes të një PEI të ri? Apo e pezullimit prej 3 orësh dhe pastaj kalimit në një proces votimi manual? Apo, besoj se kaq informacion zoti sekretari i Përgjithshëm duhet ta ketë!?

**Z. E. Lako:** Zoti Sekretar i Përgjithshëm, mundeni të jepni ndonjë përgjigje për kërkesat që bëri përfaqësuesi i LSI-së?

*Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. Y. Merkaç:** Po, sapo komunikova me personin, i cili ka verifikuar paisjet PEI dhe më thotë që 38 paisjet PEI nuk kanë punuar që nga mëngjesi, që nga ora 07:00 e mëngjesit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, zoti sekretar i Përgjithshëm. Zoti Kaziaj?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk kanë punuar që nga mëngjesi? Po ato 3 të tjerat? Zoti Sekretar i Përgjithshëm?

**Z. L. Braho:** Çfarë janë 3 të tjerat?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** 38? tha 35 apo jo, në qoftë se nuk gaboj?

**Z. E. Lako:** 38 nuk kanë punuar, 407 kanë punuar!

**Z. L. Braho:** Pra është e mjaftueshme prova, bashkë me sqarimet?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Them se është një provë e sjellë me urgjencë dhe sqarimet kanë qenë telefonike, është e mjaftueshme në këtë rast, është e mjaftueshme për të mos qenë e vëtëmjaftueshme të themi!

**Z. E. Lako:** Dokumenti i ri që na u vu në dispozicion ka ekselitetet, nënshkrimet e personit që ka lëshuar ka dhe gjithë informacionin e nevojshëm besoj të bërë në pyetjet gjatë seancës së kaluar kështu që besoj se i plotëson kërkesat sipas asaj që deklaruar. Atëherë nëse nuk keni më komente ka ndonjë gjë për palët ka ndonjë kërkesë tjetër për ndonjë provë të re zoti Kaziaj, zoti Logu?

*Zbardhi materialin audio  
Albana Ndoci*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

**Z. E. Lako:** Po zoti Logu!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit i nderuar! Nga ana jonë pasi janë refuzuar 19 herë kërkesat për transparencë e bërë nga PD-AN, nuk mendojmë se na mbetet diçka tjetër. Duke qenë se ne jemi të bindur se hetimi administrativ që ju keni zhvilluar është jo i cunguar, është jashtëzakonisht i cunguar. Pra, ju keni bërë një hetim për të arritur ato konkluzione që dëshironi, kështu që nuk kemi çfarë provash të tjera të kërkojmë, sepse ju në çdo rast do t'i refuzoni siç keni bërë 57 herë në tre raste të kërkesave tona ankimore.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Logu! Zoti Kaziaj!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk kemi prova të tjera, faleminderit!

**Z. E. Lako:** Meqenëse përfaqësuesi i palës së interesuar nuk ndodhet në seancë dhe ka dijani për zhvillimin e seancës, në mbështetje të pikës 2 të nenin 141, i japim fund hetimit administrativ. Ftojme palët të shtrojnë pretendimet përfundimtare, duke filluar nga zoti Logu!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit i nderuar, konkluzionet i kemi në shtatë faqe, kemi tre kopje për Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, mund t'ua ve në dispozicion. Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, Partia Demokratike e Shqipërisë në emër të Aleancës për Ndryshim, paraqiti para jush këtë material ankimues prej 51 faqesh, të mbështetur në 31 prova, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar të gjitha shkeljet ligjore që kanë ndodhur në zonën zgjedhore Qarku Vlorë, në periudhën para, gjatë dhe paszgjedhore. Konkretisht:

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

Ne parashtroam përpara këtij komisioni, duke besuar në drejtësinë e vendimmarrjes së saj, se shtetasi Afrim Qendro, me detyrë nënkryetar i Bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me shtetasit Klodian Troci, drejtor i ASHK Vlorë dhe Erion Osmanaj, drejtor i OSHEE Vlorë, kishin ngritur një strukturë kriminale të blerjes së votave, nëpërmjet parave, ndihmave ushqimore, kuponave të kartave të identitetit, dhënies së përfitimeve të tjera, por edhe nëpërmjet kërcënimeve e presioneve. Ndaj këtyre shtetasve, ne parashtroam para jush se Partia Demokratike ka depozituar në SPAK një kallëzim penal në datën 02.04.2021 për veprat penale të korrupsionit aktiv/pasiv në zgjedhje dhe përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore. Ne iu parashtroam se në datën 21.04.2021, disa orë përpara se kryetari i PD-së të shkonte në një takim në Selenicë, në fshatin Poro është qëlluar me kallashnikov mbi lokalit e një anëtarit dhe aktivisti të Partisë Demokratike, i cili përdorej për të zhvilluar takimet e mbështetësve të këtij subjekti zgjedhor. Ky veprim është bërë me qëllim frikësimin e mbështetësve tanë për të votuar në zgjedhjet e 25 prillit. Ne paraqitëm foto dhe video se si deputetët Vilma Bello, Vullnet Sinaj dhe Alket Hyseni ishin angazhuar në shpërndarje ndihmash ushqimore ndaj familjeve të varfra në këmbim të votës. Ne paraqitëm para jush vendimin e Këshillit Bashkiak Vlorë të datës 25.02.2021, për akordimin e kredive të buta, në një kohë kur neni 91, pika 4 ndalon shprehimisht nxjerrjen e akteve nënligjore që sjellin përfitime për kategori të caktuara shoqërore në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve. Ne iu parashtroam se vetëm një ditë përpara zgjedhjeve, zyra rajonale e bujqësisë Vlorë shpërndau tollona karburanti për fermerët në këmbim të votës. Krahas 31 provave tona, ne iu treguam provat e tjera që ju duhet të merrnit për të vërtetuar pretendimet tona pranë Prokurorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokurorisë së Përgjithshme, pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit, pranë Drejtorisë së Rezervave Materiale të Shtetit dhe Inspektoriatit Qendror dhe inspektorateve të tjera. Por këto prova u refuzuan nga ana juaj. Ju refuzuat në kundërshtim me nenin 137 të Kodit

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

Zgjedhor të drejtën e palëve për të bërë transparencë mbi blerjen e votës në Qarkun e Vlorës. Ne iu parashtruam se si shteti vendosi në dispozicion të Partisë Socialiste tenderat, koncesione, PPP-të dhe të gjitha investimet publike. Kjo shkelje flagrante e nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 të Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator u përsërit në 781 raste në të gjithë vendin. Ne iu treguam me fakte dhe prova se si shtetasit Damian Gjikhuri, Afrim Qendro, Flamur Mamaj, drejtues dhe zyrtarë të lartë të Partisë Socialiste, u shfaqën në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ-së, duke promovuar investimet publike për qëllime të pastra elektorale. Ne iu parashtruam përpara këtij komisioni duke besuar në drejtësinë e vendimmarrjes së tij se si Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës shpalli dhënien me koncesion dhe PPP të portit turistik të Vlorës në datën 06.01.2021, një shkelje flagrante kjo e nenit 3, pika të Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së, që ndalon shprehimisht dhënien e koncesioneve apo PPP-ve në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve. Krahas 31 provave që iu vumë në dispozicion, ne iu treguam ju provat e tjera që ju duhet të merrnit për të vërtetuar pretendimet tona pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike për numrin e tenderave, koncesioneve, apo PPP-ve të shpallura rishtazi apo për të cilat janë shpallur fituesit në periudhën Dhjetor 2020 – Maj 2021. Por, edhe këtë provë ju refuzuat ta merrnit. Ju refuzuat të drejtën e qytetarëve për të bërë transparencë, se si paratë e tyre u vendosën në funksion të Partisë Socialiste në Qarkun e Vlorës. Ne iu parashtruam se punonjësit e administratës shtetërore në Vlorë, Sarandë, Delvinë, Finiq, Konispol, Himarë dhe Selenicë, u kërcënuan, u intimiduan dhe u vendosën nën presion të vazhdueshëm nga eprorët e tyre për të marrë pjesë detyrimisht në takime elektorale, për të dorëzuar lista me emrat e 30 deri në 50 votuesve, për të dhënë kartat e tyre të ID apo të dhëna të tjera personale, për të pëlqyer apo shpërndarë postime në rrjete sociale, për t'u përfshirë në fushatën derë më derë, dhe për të dhënë përfitime të ndryshme për mbështetësit e Partisë Socialiste. Ne iu parashtruam përpara këtij komisioni, duke

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

besuar në drejtësinë e vendimmarrjes së tij, se administrata shtetërore u rrit me 13 mijë punonjës në rreth katër muaj dhe nga buxheti i shtetit u paguan mbi 63 milionë euro paga më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ne parashtruam përpara këtij komisioni dhe sollëm fakte e prova se si Damian Gjicknuri drejtues politik i Partisë Socialiste në Qarkun Vlorë, së bashku me Afrim Qendron nënkryetar i bashkisë, organizonin takime me punonjës të administratës publike në pallatin e kulturës Vlorë, duke i kërcënuar se në rast mos mbështetjeje të PS-së dhe kandidatëve të saj, ata do të largoheshin nga puna. Ne iu parashtruam se qeveria pagoi 2.6 milionë euro më shumë ndihma ekonomike për periudhën Janar – Prill 2021, se e njëjta periudhë e vitit të mëparshëm, ndërkohë që u shpërndanë paga lufte për 6.182 persona për periudhën Janar – Prill 2021. Krahas provave që ne dispononim 31, ne iu treguam provat e tjera që ju duhet të merrnit për të vërtetuar pretendimet tona pranë Departamentit të Administratës Publike, 61 bashkitë e vendit, 244 shoqëritë aksionare në pronësi të shtetit, agjencitë e varësisë së ministrive dhe bashkive për numrin e të punësuarve, me kontratë të përhershme apo të përkohshme, dhe si ka ndryshuar ky numër përgjatë periudhës Janar 2020 – Maj 2021. Ne ju treguam provat që duhet të merrnit pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe 61 bashkitë lidhur me numërin e familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe ndryshimin e masës së ndihmës, përgjatë periudhës Janar 2020 – Prill 2021. Por, edhe këto prova, ju i refuzuat. Ju refuzuat të drejtën e qytetarëve të Qarkut Vlorë për të bërë transparencë se si administrata shtetërore, vendet e punës, ndihma ekonomike dhe pagesat e tjera sociale u vunë në dispozicion të Partisë Socialiste në Qarkun e Vlorës. Ne parashtruam përpara këtij komisioni se lejet e legalizimit dhe lejet e ndërtimit u përdorën masivisht nga Partia Socialiste dhe kandidatët e saj për t'i përkthyer në vota dhe mbështetje në zgjedhjet e 25 Prillit. Ne iu parashtruam se PD-ja kishte foto dhe video, kishte dokumente të zyrtarëve të PS-së që shfaqeshin publikisht duke shpërndarë leje legalizimi në periudhën e ndaluar

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

nga Kodi Zgjedhor. Ne parashtruam se deputetët e PS-së, Alket Hyseni dhe Vullnet Sinaj, shfaqeshin në krah të drejtorit të përgjithshëm të ASHK-së duke shpërndarë leje legalizimi, pikërisht në Qarkun e Vlorës. Ne iu parashtruam një fakt që të gjithë besoj e njihni të gjithë që jemi në këtë sallë, audio-përgjimin e drejtorit të përgjithshëm të Kadastrës ku fliste për 100.000 kërkesa për leje legalizimi që duhet të mbaheshin pezull dhe nja 60000 të tjera të cilat duheshin të shpërndaheshin me shpejtësi, në mënyrë që të përktheheshin në vota dhe mbështetje për Partinë Socialiste. Banorët e Qarkut të Vlorës e dijnë shumë mirë sepse kanë marrë njoftime nga IKMT-ja për prishjen e banesave apo bizneseve të tyre për shkak se tashmë zgjedhjet kanë përfunduar dhe as Artan Lames as Partisë Socialiste nuk i duhet më mbështetja e këtyre njerëzve. Krahas 31 provave tona, ne iu treguam provat e tjera që ju duhet të merrnit për të vërtetuar pretendimet tona pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, 61 këshillave bashkiakë për lejet e ndërtimit, apo agjensive të kadastrës, lidhur me faktin që në periudhën Janar – Prill 2021, janë shpërndarë 10.003 leje legalizimi. Zoti Rusmali pyeti se sa prej këtyre lejeve janë shpërndarë qark pas qarku dhe kur ne i treguam që provën duhet ta merrte pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, ai i pari, refuzoi ta merrte këtë provë, duke bërë kështu bashkë me kolegët e tij noterë të masakrës zgjedhore të 25 Prillit. Ju refuzuat të bëni transparencë për lejet e ndërtimit dhe lejet e legalizimit, të cilat u shpërndanë masivisht vetëm e vetëm që Partia Socialiste të merrte vota falë përdorimit të aseteve dhe burimeve publike. Ne iu parashtruam se si shteti vendosi të dhënat personale të qytetarëve, përfshirë të dhënat e gjithë ne që jemi këtu, numra telefoni, karta identiteti, vendbanimi, vendin e punës, përfshirë dhe bindjet politike vetëm e vetëm që këto më pas të përdreshin nga serverat e Partisë Socialiste. Unë i nderuar, qoftë dhe si qytetar por dhe si përfaqësues i Partisë Demokratike dhe Aleancës për Ndryshim, nuk mund ta pranoj kurrësesi në këtë sallë që të dhënat e mia personale, apo të dhënat personale të qytetarëve shqiptarë të përdoren për qëllime elektorale të një partie, qoftë kjo dhe

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

Partia Socialiste me të plotfuqishmit e saj. Ne iu paraqitëm prova se si shtetasi Edi Rama, me detyrë kryetar i Partisë Socialiste, shtetasi Taulant Balla, me detyrë sekretar i përgjithshëm i Partisë Socialiste, shtetasi Damian Gjijnuri, me detyrë anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste, u shfaqën publikisht duke falenderuar patronazhistët për gjoja një rezultat historik siç ishte ai i 25 prillit. Ju vendosët të mos ndaleshit për asnjë moment në këtë pikë, se pavarësisht qëndrimeve tuaja të njëanshme, e dini se kjo është një shkelje e përmasave ndërkombëtare, që do të trondiste themelet e çdo shteti normal, kudo në botë. Ne iu treguam provat e tjera që ju duhet të merrnit pranë Prokurorisë së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për të vërtetuar apo lidhur me hetimet e kryera për skandalin e mbledhjes, përpunimit, përdorimit dhe publikimit të paligjshëm të të dhënave personale të qytetarëve. Por, pa asnjë surprizë edhe këtë provë, ju refuzuat ta merrnit. Ju refuzuat të drejtën e qytetarëve për transparencë dhe më dëgjoni zoti Rusmali, transparencë jo vetëm për votuesit e Partisë Demokratike por dhe të Partisë Socialiste, e kujt do partie tjetër në Republikën e Shqipërisë për të ditur se çfarë u bë me të dhënat e tyre personale në zgjedhjet e 25 Prillit. Ne iu parashtruam se vendimi i Komitetit Teknik të Ekspertëve për karantinimin 2-javor të emigrantëve, i cili u hoqi të drejtën 500000 emigrantëve shqiptarëve me të drejtë vote që jetojnë në Greqi apo Maqedoninë e Veriut, ishte një shkelje e rëndë e nenit 45 të Kushtetutës, apo nenit 3 të protokollit nr.1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ne iu parashtruam gjithashtu në këtë sallë dhe përpara këtij komisioni duke besuar në drejtësinë e vendimmarrjes së tij se vendimmarrjet e paligjshme siç ishte rasti i fletëve të votimit sollën që vetëm në Qarkun e Vlorës, të kishim 4.730 fletë votimi të pavlefshme. Nuk u ndalët për asnjë moment për ta shqyrtuar këtë çështje. Mbase qëndrimin juridik apo politik e kishit të qartë, për të kërkuar ndjese morale 83 mijë qytetarëve që iu prodhuat aq shumë konfuzion sa nuk arritën të shprehnin vullnetin e tyre. Ne iu parashtruam se strukturat e Partisë Demokratike sollën denoncime të

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

shumta për rastet e votimit të shumëfishtë, votimit familjar, votimit për të tretët apo falsifikimit të mjeteve të identifikimit. Fatmirësisht ne arritëm të merrnim të dhënat e kryqëzuara të pajisjeve PEI, të cilat arritën të provonin qartësisht pretendimin e ngritur nga ana jonë se dhe në Qarkun e Vlorës kishte pas raste të votimit të shumëfishtë me tre, katër, apo pesë herë.

Të Nderuar Anëtarë të KAS-it,

Ne jemi sot përpara një situatë ku na janë vënë fakte dhe prova, shpjegime dhe informacione se si në Qarkun e Vlorës pati raste flagrante të blerjes së votës nga drejtues të Partisë Socialiste në bashkëpunim me individë me rekorde kriminale. Pati raste të shkrirjes së shtetit dhe Partisë në një të vetëm, siç dhe u konstatua dhe nga raporti paraprak i OSBE/ODIHR-it. Pati raste konkrete të vjedhjes dhe përdorimit të paligjshëm të të dhënave personale të qytetarëve, të mohimit të të drejtës së 500 mijë emigrantëve për të votuar, të pavlefshmerisë së vullnetit të 83 mijë zgjedhësve apo rasteve flagrante të votimit të shumëfishtë. Për të provuar secilën prej këtyre krimeve zgjedhore që do ta bënë të pavlefshëm dhe të urdhëronin përsëritjen e zgjedhjeve në çdo shtet e shoqëri demokratike, ne iu vumë në dispozicion shpjegimet tona në 51 faqe dhe 31 prova, Ne kërkuam nga ana juaj, jo një herë, por plot 19 herë në këtë proces dhe 57 herë në tre procese rradhazi që kemi zhvilluar, që ju që të zbardhnit në plotëni masakrën zgjedhore të 25 prillit. Ju i refuzuat 19 herë të drejtën për transparencë 319 mijë zgjedhësve në Qarkun e Vlorës. Ne sigurisht e bëmë dhe do të vazhdojmë ta bëjmë detyrën tonë. Ne besojmë se me faktet, me provat dhe gjithëshka tjetër patëm në dispozicion arritëm të zbardhnim të plotë masakrën zgjedhore të 25 prillit në Qarkun e Vlorës. Ne treguam me fakte dhe prova se 25 prilli ishte larg të qenit një ditë zgjedhjesh të lira, të ndershme dhe të barabarta, por dita kur blerja e votës, kapja e shtetit në çdo qelizë, vjedhja e të dhënave personale, mohimi i të drejtës së emigrantëve për të votuar, paligjshmëria me fletët e votimit dhe votimi i shumëfishtë me 3, 4 apo 5 herë i një personi të vetëm, fituan mbi

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

vullnetin e qytetarëve të lirë. Sot sigurisht që është dita juaj, që pasi dëgjoni pretendimet tona të tërhiqeni për të bërë detyrën. Është dita që t'i thoni shqiptarëve a do të silleni si noterë të masakrës zgjedhore të 25 prillit siç bëtë në qarqet Gjirokastrë dhe Berat apo do të silleni si njerëz me integritet personal dhe profesional, që nuk do të lejoni që vullneti i 319 mijë zgjedhësve të Qarkut Vlorë të diktohet nga krimi dhe paligjshmëria. Vendimi ju përket ju! Cilido qoftë ai, ne do ta vazhdojmë deri në fund këtë betejë, do të shterojmë çdo mjet dhe mundësi për të hedhur dritë mbi vjedhjen më të madhe në historinë e zgjedhjeve të shqiptarëve. Sepse, e thashë dhe do të vazhdoj ta them, do ta përsëris deri në fund për secilin prej anëtarëve të këtij komisioni, për secilin që është i pranishëm në këtë sallë. Kjo betejë nuk bëhet as për ju atje, as për ne këtu, por bëhet për të gjithë ata qytetarë shqiptarë, të cilët janë viktima e vërtetë e 25 prillit, faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Logu! Fjala për ju zoti Kaziaj!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit zoti Relator. Jemi në fazën e mbylljes së hetimit administrativ që lidhet me Qarkun e Vlorës, nëpërmjet të cilit ne jemi investuar që të shpreheni me vendim në këtë rast. Gjetjet e sapolistuara të provuara nga ana e kolegut e të vëna në dispozicionin tuaj janë gjetje të karakterit alarmues se si këto zgjedhje janë vënë në dyshim, të themi nëpërmjet organizimit të gjithë shtetit të vënë në dispozicion të partisë në pushtet, e cila ka diktuar vullnetin e qytetarëve me metoda dhe mënyra jo demokratike dhe jo ligjore, duke vënë një standard të dyshimtë, duke e lënë këtë shtet dhe këta qytetarë jo të avancojnë përpara nëpërmjet reformave, nëpërmjet vënies së një standardi të caktuar për kryerjen e disa zgjedhjeve demokratike të themi, por duke i kthyer mbrapsht këta qytetarë dhe këtë shtet. Ky është një fakt shumë i rëndë i listuar nga Partia Demokratike po ashtu, i vënë në dispozicion nëpërmjet provave dhe nëpërmjet objektit ankimor në të cilin

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

ne iu kemi thirrur që të shpreheni për Qarkun e Vlorës, nëpërmjet ndryshimit të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.345, datë 04.05.2021. Duke e shpallur të pavlefshëm këtë qark pavarësisht se dyshojmë tek vendimmarrja e këtij komisioni duke qenë se jo më vonë se dita e djeshme është vënë një standard i dyshimtë dhe nga ky komision, i cili për herë të parë me ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor në formën e një kolegji siç jeni ju pretendohet se do të kishte ndryshime në vendimmarrjen nga ky komision duke bërë thellim hetimesh të kërkuara nga subjektet po edhe kryesisht me inisiativë të një ose më shumë anëtarë në fund të fundit jeni edhe ju qytetarë të kësaj Republike dhe juve i'u intereson e ardhmja e fëmijëve tuaj ashtu si na intereson dhe ne, nuk duhet të ndahemi në këtë pjesë. Për më shumë ne kemi kontestuar atë që është një vendimmarrje politike e bërë nëpërmjet urdhërit të Ministrit për Shendetësinë dhe Mbrojtjen Sociale që mban nr. 219, datë 19.04.2021 "Për vendosjen në karantinë 2 javore të shtetasve që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut", një urdhër krejtësisht politik i njëanshëm që ka etiketuar opozitën, që ka etiketuar dhe ka pamundësuar pjesëmarrjen e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, qytetarëve tanë, të cilët përkohësisht jetojnë jashtë kufijëve të kësaj Republike, që ka bërë që tabelat përmbledhëse të rezultateve kryesisht dhe jo vetëm, por meqenëse jemi në shqyrtimin e këtij ankimi në Qarkun e Vlorës të jenë me numra dhe shifra alarmante duke parë mospjesëmarrjen totale të zgjedhësve. Fletë votimi të papërdorura..., shoh dhe kam parasysh 208260 fletë të pavlefshme, 4730 këto janë shifra alarmante, të cilat ky urdhër nëpërmjet ndalimit të tyre ka pamundësuar pjesëmarrjen në votim dhe ka mundësuar ardhjen e qytetarëve shqiptarë për t'u shprehur me votë. Kjo është vetëm një nga ato çfarë ankimohet në kërkesën tonë ankimore në këtë fazë përmblylëse në bazë të nenit 141 pika 2. Të nderuar anëtarë të komisionit duke parë dhe gjetjet paraprake të OSBE/ODIHR të cilat janë të mirëpërcaktuara nga një organizëm ndërkombëtar i pavarur, apolitik që në materialin paraprak ve në dukje dhe mbështet me forcë të

*Zbardhi materialin audio*

*Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

madhe ato që janë pretendimet tona dhe të Partisë Demokratike dhe Aleancës për Ndryshim lidhur me vendimmarrjet shtetërore, lidhur me keqmenaxhimin e burimeve njerëzore dhe burimeve shtetërore, lidhur me shpërndarjen të pamasë të të mirave materiale kundrejt personave që do të votonin apo kishin marrë angazhimin për të mbështetur subjektin politik Partia Socialiste. Alarmante ishte dhe shkresa e Avokatit të Popullit që mban numrin e protokollit 222, datë 21.04.2021 drejtuar Ministrin për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale ku kërkohet me urgjencë të anulohet urdhëri politik që cënonte të drejtën kushtetuese për votë të qytetarëve shqiptarë. Po ashtu, dhe institucioni i Presidentit të Republikës si mbrojtës i të drejtave të qytetarëve shqiptarë, i cili me urgjencë ka kërkuar anulimin e këtij urdhëri drejtuar Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për dijeni po ashtu Kuvendit të Shqipërisë, Avokatit të Popullit dhe vetë KQZ-së nga e cila ka kërkuar që të shprehen mbi këtë urdhër. Jo më vonë se dita e djeshme ne jemi njohur me materialin që debatuar lidhur me përplasjen e të dhënave nga kryqëzimi i bërë nga pajisjet PEI. Pra, të dhëna elektronike këto që materiali i debatuar pak më parë ngre jo vetëm dyshime po jep provë mbi raste të përsëritura të votimit të një personi për disa shtetas të tjerë. Kjo duhet të jetë alarmante dhe kjo gjë duhet të ishte hetuar me iniciativë të KAS-it, ky proces nuk duhet si rregull të përfundonte sot. Po fakti është që standardi i mbajtur nga ana juaj për të mos hetuar çështje të këtij karakteri po sjell një standard të themi të dyfishtë, e cila çon në orientim politik pra, vendimmarrja juaj nuk ka qenë objektive deri në këto momente të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Në këto kushte pavarësisht gjithçkaje duke parë fazën procedurale, administrative në të cilën ndodhemi kërkojmë nga ana juaj të risillni ligjshmëri në vendimmarrjet tuaja duke qenë objektiv, duke vendosur standarde dhe ju europiane duke përmbushur pritshmëritë e çdo qytetari shqiptar duke përmbushur pritshmëritë e një ligji të posaçëm nëpërmjet të cilit ju disponoheni. Për sa më sipër i'u kërkojmë të shpreheni me vendim duke e ndryshuar

*Zbardhi materialin audio*

*Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2021*

vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që mban nr. 345, datë 04.05.2021, shpalljen e pavlefshme për zgjedhjet në Qarkun e Vlorës duke i përsëritur ato, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Kaziaj. Atëherë meqenëse dhe përfaqësuesi i palës së interesuar nuk është në seancë, por qëndrimet i ka shprehur tek prapësimet që ka bërë. Atëherë, KAS do të tërhiqet për vendim dhe do ta shpallim vendimin në orën 14:00, faleminderit. Po e shpallim dhe vazhdojmë me Beratin.

**Rifillon mbledhja**

**Ora 14:05**

**Z. E. Lako:** KAS, në përfundim të shqyrtimit administrativ të kërkesave ankimore nr. 36 dhe 49, bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, me shumicë votash, mbështetur në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, Vendosi:

1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 36, datë 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD - AN);
2. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 49, datë 10.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim
3. Lënien në fuqi të vendimit nr. Nr. 345, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore qarku Vlorë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Faleminderit!

**Vendimi nr.87**

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*

